

Kumbona e së Diellës



KRYEDIOQEZA METROPOLITANE SHKODËR - PULT

Nr.9/10, Shtator - Tetor 2017

SHËN PATRIKU

(MAGONUS SUCATUS PATRICIUS)

IPESHKËV DHE PAJTORI I IRLANDËS (385-461)

Më 17 mars Kisha e përkujton Shën Patrikun, ipeshkëv. Lindi rreth vitit 385 në Angli përkatësisht në Skotlandë nga prindërit krishterë. Në pagëzim japin emrin Magonus Sucatus Patricius. Babën e kishte të shuguruar xhakon dhe më vonë edhe shugurohet për meshtar. Fillimisht Patriku kalojë një jetë të lehtë që nuk u interesuar as për shkollë, për dije dhe fe. Kur i kishte 16 vjeç, piratët Irlandës e zënë rob dhe disa mija tjerë, që çuar në Irlandë dhe i shesin si skllavër. Pronari i Patrikut e çoi për t'i kullosë delet. Pranë tufës së deleve në shkretëtirë, në vetmi si dhe në skllavëri i afrohet Zotit. U lutë shumë bë bënte pendesë. Pas 6 viteve skllavërie, dëgjojë një zë se do të çlirohet. Pasi e rifitoi lirinë, kthehet në shtëpi vet në Britani. Pastaj shkon në Gali përkatësisht në qytetin Auxerre dhe nën udhëheqjen e ipeshkëvit asaj kohë Shën Germanit studio teologjinë dhe shugurohet për xhakon pastaj meshtar. Pastaj, i zgjedhur ipeshkëv i Irlandës, me zell të madh e shpalli Ungjillin ndër popujt e atij ishulli, duke kthyer shumë prej tyre në fe krishtere. Pati merita të mëdha në themelimin e hierarkisë kishtare të ishullit. Në kohën e Shën Patrikut fillon të lulëzojë jeta rregulltarë që më vonë do të kenë një ndikim të madh në Evropë. Selinë ipeshkëvnore e themeloi në Armagh në Ulster, ku sot është selia e kardinalit dhe primate të Irlandës. Vdiq në Down (në Irlandën e Veriut) më 17 mars 461.

Shën Patriku ishte mbrojtësi nga kafshimi I gjarpërinjve.

Sot Shën Patriku nuk është vetëm mbrojtës (Pajtori) i Irlandës, por edhe Irlandezeve në Amerikë, (është e njohur Katedralja e New Yorkut) pastaj pajtori i Nigerisë dhe mbrojtës i inxhinierëve si dhe mbrojtës nga gjarpërinjtë.

Përndryshe është festa nacionale e Irlandës, kremtohet edhe në SHBA, Australi etj.





Papa Fraçesko	4
MISIONI NË ZEMRËN E FESË SË KRISHTERË	
Redaksia	6
MIKEL KOLIQI	
Dom Lush Gjergji	7
RABINDRANATH TAGORE	
Don Nosh Gjolaj	10
PUSHIMI DHE UDHTIMI I PROGRAMUAR	
Giovanni Cussi S. I.	13
ÇIFTI DHE SFIDAT E KOHËS	
Redaksia	16
PATER ANTON HARAPI:	
Gjovalin Muzhani	18
NËNA SUPERIORE KONSILE MUZHANI	
Ndue DEDAJ	24
PREND DOÇI, ABATI I LIRISË DHE DITURISË	
Redaksia	27
NËNË TEREZA DHE ÇMIMI NOBEL	
Redaksia	28
VITRINA E LIBRIT	

MISIONI NË ZEMRËN E FESË SË KRISHTERË

Mesazhi i Atit të Shenjtë Françeskut për ditën misionare botërore 2017

Të dashur vëllezër e motra,
edhe këtë vit Dita Misionare Botërore na thërret përreth personit të Jezusit, «ungjillëzuesit të parë dhe më të madh» (Pali VI, Nxiti. ap. Evangelii nuntiandi, 7), që vazhdimisht na dërgon për të shpallur Ungjillin e dashurisë së Hyjit Atë me fuqinë e Shpirtit Shenjt. Kjo Ditë na fton të reflektojmë përsëri në lidhje me misionin në zemrën e fesë së krishterë. Në të vërtetë, Kisha është misionare për nga natyra; po të mos ishte e tillë, nuk do të ishte më Kisha e Krishtit, por një shoqatë mes shumë të tjerash, që shumë shpejt do të arrinte ta humbiste qëllimin e vet dhe të zhdukej. Prandaj, jemi të ftuar t'i shtojmë vetes disa pyetje që prekin vetë identitetin tonë të krishterë dhe përgjegjësitë tona si besimtarë, në një botë të përshtetur nga shumë iluzione, të plagosur nga frustracione të mëdha dhe të sakatuar nga luftëra të shumta vëllavrasëse që padrejtësisht godasin veçanërisht të pafajshmit. Cili është themeli i misionit? Cila është zemra e misionit? Cilat janë qëndrimet jetësore të misionit?

Misioni dhe fuqia shndërruese e Ungjillit të Krishtit, Udhë, e Vërtetë dhe Jetë

1. Misioni i Kishës, i drejtuar të gjithë njerëzve vullnetmirë, është i bazuar në fuqinë shndërruese të Ungjillit. Ungjilli është një Lajm i Mirë që bart në vetvete një gëzim ngjithës sepse përmban dhe jep një jetë të re: atë të Krishtit të ringjallur, i cili, duke komunikuar Shpirtin e vet gjallërues, bëhet Udhë, e Vërtetë dhe Jetë për ne (krh. Gjn 14,6). Është Udhë që na fton ta ndjekim me besim dhe guxim. Duke ndjekur Jezusin si Udhë jonë, ne përjetojmë të Vërtetën dhe marrim Jetën e tij, që është bashkim i plotë me Hyjin Atë në fuqinë e Shpirtit Shenjt, na bën të lirë prej çdo forme egoizmi dhe është burim krijimtari në dashuri.

2. Hyji Atë e do këtë shndërrim ekzistencial të bijve dhe bijave të tij; shndërrim që shprehet si kult në shpirt dhe të të vërtetë (krh. Gjn 4,23-24), në një jetë të frymëzuar prej Shpirtit Shenjt në imitim të Birit Jezus për lavdi të Hyjit Atë. «Lavdia e Hyjit është njeriu i gjallë» (Ireneu, Adversus haereses IV, 20, 7). Në këtë mënyrë, shpallja e Ungjillit bëhet fjalë e gjallë dhe efikase që aktualizon atë që shpall (krh. Is 55,10-11), pra, Jezu Krishtin, i cili vazhdimisht bëhet njeri në çdo situatë njerëzore (krh. Gjn 1,14).



Misioni dhe kairos-i i Krishtit

3. Pra, misioni i Kishës nuk është përhapja e një ideologjie fetare dhe as propozimi i një etike sublime. Shumë lëvizje në botë dinë të prodhojnë ideale të larta apo shprehje etike të rëndësishme. Nëpërmjet misionit të Kishës, është Jezu Krishti ai që vazhdon të ungjillëzojë e veprojë, dhe prandaj ajo përfaqëson kairos-in, kohën e volitshme të shpëtimit në histori. Nëpërmjet shpalljes së Ungjillit, Jezusi bëhet gjithnjë e përsëri bashkë-kohësi ynë, me qëllim që ai që e pranon me fe e dashuri të përjetojë forcën shndërruese të Shpirtit të tij prej të Ringjalluri që e bën të frytshme njerëzoren dhe botën e krijuar ashtu siç bën shiu me tokën. «Ringjallja e tij nuk është diçka e së kaluarës; përmban një forcë jete që ka depërtuar në botë. Aty ku duket se gjithçka ka vdekur, nga çdo anë fillojnë të shfaqen sythet e ringjalljes. Është një forcë e pashoqe» (Nxiti. ap. Evangelii gaudium, 276).

4. Të kujtojmë gjithmonë se «në fillim të të qenurit të krishterë nuk gjendet një vendim etik apo një ide e madhe, por takimi me një ngjarje, me një Person, që i jep jetës një horizont të ri dhe me këtë drejtimin vendimtar» (Benedikti XVI, Let. enc. Deus caritas est, 1). Ungjilli është një Person, i cili vazhdimisht dhurohet dhe vazhdimisht i fton ata që e pranojnë me fe të përvuajtur e vepruese për të bashkëndarë jetën e tij nëpërmjet një pjesëmarrjeje efektive me misterin e tij pashkor të vdekjes dhe ringjalljes. Ungjilli bëhet kështu, nëpërmjet Pagëzimit, burim i jetës së re, të lirë prej sundimit të mëkatit, të ndriçuar e të shndërruar prej Shpirtit Shenjt; nëpërmjet Krezmimit, bëhet lyerje forcuese që, falë të njëjtit Shpirt, tregon ecje dhe strategji të reja të dëshmisë e afërsisë; dhe nëpërmjet Eukaristisë bëhet ushqim i njeriut të ri, «ilaç pavdekësie» (Injaci i Antiokisë, Epistula ad Ephesios, 20, 2).

5. Bota ka thelbësisht nevojë për Ungjillin e Jezu Krishtit. Ai, nëpërmjet Kishës, vazhdon misionin e vet si Samaritan i Mirë, duke kuruar plagët e përgjakura të njerëzimit, dhe si Bari i Mirë, duke i kërkuar pa pushim ata që kanë humbur shtigjeve të shtrembëra e pa cak. Dhe falë Hyjit nuk mungojnë përvoja domethënëse që dëshmojnë forcën shndërruese të Ungjillit. Mendoj për gjestin e atij studentit Dinka që, me çmimin e jetës së vet, mbron një student të filit Nuer të caktuar për t'u vlarë. Mendoj për atë kremtim eukaristik në Kitgum, në Ugandë e Veriut, në atë kohë e përgjakur prej egërsisë së një grupi rebelësh, kur një misionar i bëri njerëzit të përsërisnin fjalët e Jezusit në kryq: «Hyji im, Hyji im, përse hoqe dorë prej meje?», si shprehje e britmës së dëshpëruar të vëllezërve e motrave të Zotërisë së kryqëzuar. Ai kremtim që për njerëzit burim ngushëllimi të madh dhe guximi të madh. Dhe mund të mendojmë edhe për dëshmi të shumta, të panumërta të asaj se si Ungjilli ndihmon për të kapërcyer mbylljet, konfliktet, racizmin, tribalizmin, duke nxitur kudo dhe mes të gjithëve pajtimin, vëllazërinë dhe bashkëndarjen.

Misioni frymëzon një përshtirje të daljeje të vazhdueshme, shtegtimi dhe mërgimi

6. Misioni i Kishës është i frymëzuar nga një përshtirje të daljeje të vazhdueshme. Bëhet fjalë për «të dalë nga rehatia jonë dhe për të pasur guximin të arrijmë tek të gjitha periferitë që kanë nevojë për dritën e Ungjillit» (Nxiti. ap. Evangelii gaudium, 20).

Misioni i Kishës nxit një qëndrim shtegtimi të vazhdueshëm nëpërmjet shkretëtirave të ndryshme të jetës, nëpërmjet përvojave të ndryshme të urisë dhe etjes për të vërtetë e drejtësi.

Misioni i Kishës frymëzon një përvojë mërgimi të vazhdueshëm, për të bërë që njeriu i etur për të pafundmen ta kuptojë gjendjen e tij si mërgimtar në ecje drejt atdheut përfundimtar, i prirur mes asaj që «tashmë është» dhe asaj që «nuk është ende» e Mbretërisë qiellore.

7. Misioni i thotë Kishës se ajo nuk është qëllim në vetvete, por një mjet i përvuajtur dhe një ndërmjetësim i Mbretërisë. Një Kishë autoreferenciale, që kënaqet me sukseset tokësore, nuk është Kisha e Krishtit, trupi i tij i kryqëzuar dhe i lavdishëm. Ja, pra, pse duhet të parapëlqejmë «një Kishë të dëmtuar, të plagosur dhe të pistë sepse ka dalë rrugëve, në vend të një Kise të sëmurë prej mbylljes dhe rehatisë së të kapurit pas sigurive të veta» (ibid., 49).

Të rinjtë, shpresë e misionit

8. Të rinjtë janë shpresa e misionit. Personi i Jezusit dhe Lajmi i mirë i shpallur prej Tij vzhdojnë të mahnisin shumë të rinj. Ata kërkojnë rrugëtimet në të cilat të realizojnë guximin dhe hovet e zemrës në shërbim të njerëzimit. «Janë të shumtë të rinjtë që japin ndihmën e tyre solidarë përballë të këqijave të botës dhe ndërmarrin forma të ndryshme militance dhe vullnetariati [...]. Sa gjë e bukur është që të rinjtë të jenë “rrugëtues të fesë”, të lumtur që ta çojnë Jezusin në çdo rrugë, në çdo shesh, në çdo kënd të tokës!» (ibid., 106). Asambleja e ardhshme e Përgjithshme e Zakonshme e Sinodit të Ipeshkvinjve, që do të kremtohet në vitin 2018 mbi temën “Të rinjtë, feja dhe shoshitja thirrë”, paraqitet si rast provanor për të përfshirë të rinjtë në përgjegjësinë e përbashkët misionare që ka nevojë për imagjinatën dhe krijimtarinë e tyre të pasur.

Shërbimi i Veprave Papnore Misionare

9. Veprat Papnore Misionare janë mjet i çmueshëm për të nxitur në çdo bashkësi të krishterë dëshirën për të dalë na kufijtë e sigurisë e saj dhe për t'ua shpallur Ungjillin të gjithëve. Nëpërmjet një përshtirje të thellë misionare që duhet jetuar përditë, një angazhimi të vazhdueshëm formimi dhe animimi misionar, fëmijët, të rinjtë, të rriturit, familjet, meshtarët, rregulltarët e rregulltarët, Ipeshkvinjtë janë të përfshirë në mënyrë që në secilin të rritet një zemër misionare. Dita Botërore Misionare, e nxitur nga Vepra e Përhapjes së Fesë, është rasti i volitshëm që zemra misionare e bashkësive të krishtera të marrë pjesë me lutje, me dëshminë e jetës dhe me bashkësinë e të mirave për t'iu përgjigjur nevojave të mëdha e të gjera të ungjillëzimit.

Të bëjmë mision me Marinë, Nënë e ungjillëzimit

10. Të dashur vëllezër e motra, le të bëjmë mision duke u frymëzuar prej Marisë, Nënës së ungjillëzimit. Ajo, e nxitur prej Shpirtit, e pranoi Fjalën e jetës në thellësinë e fesë së vet të përvuajtur. Virgjëra na ndihmoftë të themi “po”-në tonë në urgjencën për të bërë që të jehojë Lajmi i Mirë i Jezusit në kohën tonë; fitoftë për ne një zell të ri prej të ringjallurish për t'ua çuar të gjithëve Ungjillin e jetës që e mposht vdekjen; ndërmjetësiftë për ne në mënyrë që të mund të fitojmë guximin e shenjtë për të kërkuar rrugë të reja që të gjithëve t'u arrijë dhurata e shpëtimit.

MIKEL KOLIQI KLERIK SHEMBULL E TESTAMENT SHPIRTËROR E KOMBËTAR!

(Më rastin e 20 vjetorit të vdekjes së Kardinal Koliqit)

Më 28 janar, kujtojmë përvjetorin e vdekjes së kardinalit Mikel Koliqi, një nga figurat më të ndritura të Kishës katolike shqiptare, njeriun që u bë simbol i gjakut të martirëve, derdhur nga diktatura komuniste në Shqipëri. Këtë figurë shembullore kishtarë e kombëtare po e kujtojmë me fjalët e imzot Klaudio Maria Çelit, Kryetar i Këshillit Papnor të Komunikimeve Shoqërore, i cili në vitin 1991 e pati njohur e takuar në Shkodër dom Mikel Koliqin. Rasti që një ndër takimet e para që përfaqësuesit e Vatikanit takonin popullin e klerin e persekutuar, që posa kishin dal nga dimri egër i diktaturës ateiste të komunizmit.

I zgjodhëm pikërisht fjalët e imzot Claudio Maria Çelit, për të nënvizuar se figura si ajo e Kardinalit Mikel Koliqi, mbeten përgjithnjë në kujtesën e njerëzve, si simbol i gjakut të martirëve, derdhur nga diktatura komuniste në Shqipëri. Ja si e kujtoi Imzot Çeli, vetëm dy ditë më parë, në sa përshkruante Meshën e kremtuar në Katedralen e Shkodrës, më 21 mars 1991: “Sapo e kishim filluar Meshën, kur hyri në Kishë monsinjor Koliqi. Ishte vikari i përgjithshëm, që kishte shpëtuar gjallë nga persekutimi: fizikisht i shkatërruar, por tmerrsisht i gjallë e i fuqishëm në shpirt.

Hyri në Kishë i mbajtur për krahësh nga dy të rinj. Figurë interesante, emocionuese. Madje fjala interesante nuk mjafton për të shprehur atë që ndjemë të gjithë atë çast, sepse ishte një pamje e papërshkrueshme. Më tha: “Unë nuk dal ma prej shtëpie, por kur më thanë se ju jeni këtu, e ndjeva për detyrë të isha i pranishëm, në një çast kaq të pritur, kur përfaqësuesi i Papës asht mes nesh!

Fillova homelinë. E kujtoj akoma, sepse më delte nga zemra, pa pasur nevojë fare për përgatitje. E, me që ishte data 21 mars 1991, shqiptova fjalët: “Dimri po shkon! Sot fillon pranvera!”.

E, Kardinali Koliqi vijon të jetë për popullin shqiptar edhe pas vdekjes një jetë kushtuar Zotit e popullit, në një kohë kur ky përkushtim paguhej me jetë. Një jetë e jetuar për Zot e popull, për fe e atdhe, për Ungjill e kulturë.

E vërtetë nuk është e thjeshtë të përmbledhësh me pak fjalë jetën e kardinalit Koliqi, një nga figurat më poliedrike në historinë e Shqipërisë.

Mikel Koliqi lindi në Shkodër më 29 shtator 1902. Shkollën fillore e kreu në vendlindje, për t'i vijuar studimet në Milano të Italisë, ku edhe u diplomua në degën e inxhinierisë mekanike, në Politeknikumin e



Milanos. Ishte në moshë të pjekur, kur ndjeu thirrjen për rrugën meshtarake, thirrje që e kurorëzoi duke u shuguruar meshtar më 30 maj 1931. U kthye menjëherë në Atdhë dhe nisi shërbimin, më parë si ndihmës-famullitar, e pastaj si famullitar i katedrales së Shkodrës. U shqua edhe për veprimtarinë e tij muzikore e publicistike. Muzikoi melodramat e para në historinë e muzikës shqiptare, në bashkëpunim të ngushtë me Dom Ndrë Zadejën. Qe kryeredaktor i revistës "Kumbona e së Dieles". Gjatë regjimit komunist u burgos tri herë dhe u dënua me 40 vjet heqje lirie.

Papa Shën Gjon Pali II e emëroi prelat nderi (monsinjor) në janar 1992, e takoi personalisht gjatë vizitës së tij në Shkodër, më 25 prill 1993 dhe e krijoi kardinal më 26 nëntor 1994 në Vatikan.

Menjëherë pas fillimit të proceseve demokratike të Shqipërisë, kardinali Mikel Koliqi u nderua së pari me titullin "Pishtar i demokracisë", më pas me titullin "Nënë Tereza" dhe, vetëm pak ditë para vdekjes, me titullin më të lartë "Nderi i Kombit". Vdiq në Shkodër, më 28 janar 1997. U përpoqëm të përmbledhim në pak rreshta një jetë të veçantë siç që ajo e dom Mikel Koliqit, që shtrihet në gjithë hapësirën e shekullit të kaluar, një jetë e jashtëzakonshme për Fé e Atdhë që mbeti hallkë e pashkëputur nga tmerri i persekutimit ateist të komunizmit. E jeta dhe veprimtaria e kardinalit Mikel Koliqi që e është për të gjithë shqiptarët shembull e testament shpirtëror e kombëtar, pra mbetet një udhërrëfyes për të gjithë ne, se si duhet punuar të bashkuar e në mirëkuptim për një të ardhme më të mirë për popullin e vendin, me një përkushtim e përvujtëri, duke kërkuar e përvetësuar gjithmonë vlerat e vërteta e të shëndosha, njerëzore, shoqërore e shpirtërore e, kulturore e kombëtare.

Dom Lush GJERGJI
Prishtinë

RABINDRANATH TAGORE

(1861 – 1941)

„Unë jam rruga, e Vërteta dhe Jeta – Jezusi u përgjigj. – Askush nuk shkon tek Ati pos nëpër mua.“ (Gjn 14, 6).

„Unë jetoj në këtë botë dhe kam frikë mos e bëjë atë bile pak më të vogël. Më ngrit në botën tënde, o Zot, dhe më jep lirinë që ta humbas veten time të tërën me gëzim... O Zot, më jep forcë që të mund i qetë t'i barti gëzimet dhe dhimbjet, më jep forcë që dashuria ime të jetë e dobishme dhe frytdhënëse; më jep forcë që të ngirti vdekjen time përmbi imtësitë e përditshme... Nëse në këtë jetë nuk mundi ta kundroj Fytyrën Tënde, O Zot, më jep mundësinë të shijoj se sa e vështirë është mungesa e jote. Më mundëso të mallëngjehem për Ty sa jam në vigjilje dhe në ëndërr!... Ata të cilët i kanë të gjithat pos Teje, O Zot, tallën me ata të cilët të kanë vetëm Ty.”

Rabindranath Tagore u lind në Kalkutë me 7 maj 1861 në një familje vërtet të njohur dhe të pasur, si fëmija i katërmëdhjetë. Kjo gjendje familjare, i dha mundësinë që të rritet në qetësi dhe në harmoni, në familje me shumë të mira shpirtërore dhe lëndore. Kishte mundësi të udhëtonte pothuaj në të gjitha pjesët e botës. Ai i shfrytëzoi mirë këto mundësi, nuk mbeti në rrafshin e fakteve, dukurive, por gjithnjë hulumtoi shkaktarët historik dhe personalitetet, lidhjen mes jetës dhe vdekjes, të mirës dhe të keqes, gëzimit dhe pikëllimit.

Edhe pse kishte prejardhje nga një familje mjaft e pasur dhe shumë e njohur, kurrë nuk mbeti skllav i të mirave materiale, nuk u mbyll në egoizëm dhe egocentrizëm të kënaqësive, luksit dhe jetës së komode. Përkundrazi, nga përvoja personale arriti deri te pasuria e së Vërtetës dhe Dashurisë për Hyjin dhe të afërmin, siç pohonte.

Qysh si i ri e donte kulturën, letërsinë, në veçanti poezinë. Thoshte: „Dashuria ime ndaj poezisë ishte aq e madhe, më e fortë se unë, kështu që askush nuk ka pasur mundësi të më ndalonte shkrimin... Në familjen tonë tashmë ekzistonte atmosfera e letërsisë dhe artit... Vëllai im poet Jyotirindranathi më tepër se të gjithë të tjerët zhvilloi në mua shijen e Me syqeltësi mblodhi përvojat jetësore, me arsye mendoj mbi to, me zemër të sinqertë dhe të pastër kultivonte ndjenjën fisnike dhe bujare të dashurisë, nëpërmjet muzikës, këngës, idesë, siç u shpreh, iu dhurua të tjerëve. E dashuroi shumë letërsinë. Edhe më tepër, shqyrtimin, mendimin, qetësinë. Kërkoi mënyra si të pajtonte dhe bashkonte dy bota

tërësisht të kundërta: Lindjen dhe Perëndimin e krishterë. Burimi i pashtershëm i mendimit dhe krijimtarisë artistike, ishte dhembja, vuajtja e motivuar, e pranuar dhe përjetuar denjësisht.

Në rininë e hershme humbi nënën. Kjo vdekje, në të shkaktoi një zbrazëti të madhe, plagë të thellë. Këtë zbrazëti dhe shërimin e kësaj plaje filloi ta plotësonte me kërkimin e të Vërtetës – Zotit.

Zot, unë bredh në kërkim,
rrenë është buzëqeshja,
rrenë është vaji,
eja e shpërndaje gabimin tim...
dhe derisa unë shtegtoj prej derës në derë,
çdo hap më afronte dhe udhëhiqte
më afër derës tënde kryesore.

Më vonë, pati edhe goditje tjera të tejet rënda: vdekja e bashkëshortes Mrinalinës, vdekja e disa fëmijëve në moshën foshnjore, si dhe të vëllezërve, miqve. Kjo e bëri edhe më të ndjeshëm, më human, të sinqertë, më të afërt ndaj vetvetes, ndaj Zotit dhe të tjerëve, në kërkim të vazhdueshëm të kuptimit të vuajtjes.


Shtëpia ime është e vogël
dhe gjithçka që del nga shtëpia ime
më nuk kthehet.
Shtëpia e jote, o Zot, është e paskajshme,
dhe kush hyn aty nuk do të humbët për amshim.

Edhe pse formalisht nuk ishte i krishterë, ai njihte shumë mirë krishterimin, ndërsa edhe më mirë e jetonte, dëshmonte, dhe vazhdimisht ua dhuronte të tjerëve, duke e thirrur bile edhe vdekjen „mikeshë dhe lundruese kah siguria e amshimit“.

„Vdekja, si dhe lindja, janë pjesë përbërëse të jetës. Ecja përbëhet si në ngritjen e këmbës, po ashtu edhe në zbritjen e saj. Në ditën kur do të troket vdekja në derën tënde, me cilën dhuratë do e pritesh? Ah, unë do të dal para Zotit tim me kupën time jetësore – të cilën do t'ja dhuroj Atij, kurrë nuk do ta lë atë duarzbrazët... Të gjitha do t'i vendosi para Tij në fundin e ditëve të mia, atëherë kur do të troket vdekja në dyert e mia.”

Aktualiteti i gjeniut të tagores

E vërteta, mirësia, dashuria, paqja, liria janë disa vlera themelore për çdo kohë, kulturë dhe shoqëri,



për çdo njeri, nuk „vjetërsohen“ askurrë, e bëjnë jetën më të bukur, më të gëzueshme, më të thellë, njerëzit më të lumtur. Gjeniu i qenies njerëzore, gjatë periudhave të ndryshme, vazhdimisht ka kërkuar këto vlera themelore, përmes këtyre ka kërkuar vetveten, në fund të fundit ka kërkuar Zotin, kuptimin përfundimtar të jetës dhe të veprimtimit tonë.

Koncili i Dytë i Vatikanit, ka kërkuar në të gjitha mënyrat t'i ndihmojë njeriut bashkëkohor në këtë kërkim, duke pasur para sysh besnikërinë e dyfishtë: ndaj Hyjit dhe ndaj njeriut të kohës sonë.

“Për këtë, për zemërsisht ftohen të gjithë të krishterët „për të dëshmuar me dashuri të vërtetën“ (Ef 4, 15) “të bashkohen me të gjithë njerëzit e vërtetë të paqes për të lutur dhe ndërtuar paqen“ (GS 78).

Forca, e cila mund të bashkojë njerëzimin në një familje, të krijojë „rendin e ri botëror“ është dashuria. „Arsyeja më e lartë e dinjitetit njerëzor është ajo që njeriu është i ftuar në bashkim me Zotin. Qysh nga lindja, njeriu është i ftuar në dialog me Hyjin, sepse vetëm për këtë arsye edhe është krijuar për ta dashur Zotin; prej Tij me dashuri përcillte, dhe nuk jeton plotësisht sipas të vërtetës nëse nuk e pranon dhe nëse nuk i besohet Krijuesit të vet“ (GS 19).

Nga ky “dialog i përhershëm me Hyjin“, rritet, pjekët dhe zhvillohet dashuria ndaj të afërmeve; urdhri më i madhi është ta duash Hyjin me gjithë

zemër, kurse të afërmin tënd sikur vetveten (Krh. Mt 22, 34-49). Mirëpo, këtë urdhër të dashurisë ndaj të afërmit Jezu Krishti e ka përplotësuar dhe begatuar me përmbajtje të re duke dëshiruar të ngjasohet me çdo qenie njerëzore. “Për të vërtetë po ju them: çka do bëtë për njërin ndër këta vëllezër të mi më të vegjël, e bëtë për mua“ (Mt 25, 40). „Nëse e doni njëri-tjetrin, të gjithë do t’ju njohin se jeni nxënës të mi“ (Gjn 13, 35; krhs. AA 8). Vërtetësimi i dashurisë sonë ndaj Hyjit „zbatohet“ përmes dashurisë ndaj të afërmeve, që do të thotë ndaj çdo qenie njerëzore, pa kurrfarë dallimi, paracaktimi apo përjashtimi. Bile edhe ndaj më të vegjëlve, gjithë atyre që janë të rrezikuar, të braktisur, të harruar, barrë e vetvetes dhe të tjerëve. „Në ditët tona, në veçanti ekziston obligimi urgjent dhe i pashlyer që të jemi afër çdo njeriu dhe që kur të takohemi me të, frytshëm t’i ndihmojmë: të moshuarit të braktisur nga të gjithë, punëtorët e huaj padrejtësisht të nënçmuar, refugjatët, fëmijët të lindur nga lidhja e jashtëligjshme, të cilët vuajnë padrejtësisht për mëkatën e cili nuk është i tyre, të uriturit të cilët qortojnë ndërgjegjen tonë...“ (GS 27).

Shtegtari i rrugëve të botës, në kërkim të së Vërtetës dhe Dashurisë, në dialog të përhershëm me Hyjin dhe të afërmin, edhe pse formalisht kurrë nuk qe pagëzuar, ishte thellësisht human i krishterë, dëshmitar i madhërisë së arsyes dhe zemrës e cila kërkon dhe dashuron - ja i tillë ishte dhe mbetet Rabindranath Tagora.

Tagora, si hulumtues dhe dëshmitar i këtij lloji të veçantë, shprehu gjenialitetin e tij në mënyra të ndryshme dhe përmes mjeteve të shumta të shprehjes. Ishte mendimtar i jashtëzakonshëm burimor, vazhdimisht i frymëzuar dhe shkrimtar i thellë, edukator i shkëlqyer, muzicant i kujdesshëm, dramaturg kreativ, romancier fantastik, muzikant gjenial, një ndër personalitetet e veçanta të shekullit XX, shkrimtari më i njohur i Indisë moderne. Kishte një pasuri të madhe të brendshme, e cila e shtynte për t’iu dhuruar edhe të tjerëve përmes mjeteve dhe kanaleve të ndryshme. Gjithnjë kërkonte vlera të thella dhe të përjetshme përmes jetës së përshpirtëshme, uratës, meditimit.

Ai para Hyjit paraqitej kështu:

“O, Zot, më fol, ma thuaj një fjalë,
preke qenien time, shtrije dorën tënde
dhe më lartëso kah Ti!“

Çmimi Nobel për letërsi

Rabindranath Tagore, nw vitin 1913, me meritë e mori çmimin Nobel për letërsi. Publikoi vepra të

shumta poetike, filozofike, pedagogjike, mbi 150 tituj të ndryshëm. Shkroi dhe udhëtoi thuajse pa ndërpre, sepse dëshiroi të njohë, shohë, t'iu ndihmojë edhe të tjerëve të mendojnë, të jenë më bujarë, më humanë, më të afërt dhe më komunikativë, kështu më të pasur.

„Rrugën të cilën e shfaqti Buddha nuk është vetëm zbatim i mohimit të vetvetes, por edhe përhapja e dashurisë... Për mua, nuk është asgjë më e rëndësishme sa mirësia morale... Isha i ftuar në kremtimin e kësaj jete, dhe shi për këtë kam jetën e bekuar. Me sytë e mi kam parë dhe me veshët e mi kamë dëgjuar. Në këtë gosti jetësore, u kërkua prej meje të luaja muzikë. Dhe unë bëra gjithë atë që dita dhe munda. Tash pyetëm: „O, Zot, vallë nuk është momenti të hyj në Gostinë Tënde dhe ta shoh Fytyrën Tënde?...“

Koncili i Dytë i Vatikanit në mënyrë të hapur thotë: “Në të vërtetë, nuk mund ta thërrasim Hyjin, Atin e të gjithëve, nëse heqim dorë që të sillemi vëllazërisht ndaj disa njerëzve, të krijuar në përngjasimin e Hyjit. Marrëdhënia e njeriut ndaj Hyjit Atë në marrëdhënien e njeriut ndaj vëllazërve ndërlihet ashtu sa që Shkrimi thotë: “Kush nuk ka dashuri, nuk e ka njohur Hyjin” (1 Gjn 4, 8) (NA 5).

Tagora sot nuk është vetëm mendimtar, filozof, poet, romancier, dramaturg, por mbi të gjitha porosi jetësore për të vërtetën, dashurinë, paqen, arsyeshmërinë e vuajtjes, vëllazërinë e përgjithshme, kërkimin e vlerave shpirtërore dhe morale, lumturinë „që ka aq pak“ kurse vlen aq shumë, njeriun që „gëzon“ praninë e Zotit. Ai, deri në fund shfrytëzoi dhuratat e Hyjit, në rend të parë të mirat materiale, e më pas gjenialitetin e vet kreativ, vetëm për të mirën e të tjerëve, të gjithëve. Dhe bëri, por edhe sot bën të mira të shumta, sepse Tagora nga afër ngacmon ndërgjegjen e njeriut modern, atë ia afron Hyjit, njeriut, vetvetes, e drejton atë drejt pafundësisë, e trimëron, mbështet dhe nxit secilin në kërkim të realizimit të së mirës – të amshimit.

Tagora qysh si i ri, në vitin 1878 së bashku me të vëllain e vet shkoi në Londër për të studiuar letërsinë, atë europiane dhe botërore, edhe pse e pati regjistruar drejtësinë si profesion. Pasioni i tij ishte poezia, letërsia, të cilën e dëshmoi me shkrimin e artikujve në revistën Baharati.

Tagora nuk shkroi kurrë në mënyrën abstrakte, vetëm në anën teorike, porse u nis nga jeta konkrete, kërkoi „pse-hun“, analizoi dukurinë e varfërisë, rolin vartës të gruas në shoqërinë bengalase, jetën familjare, vuajtjen, vetminë, dashurinë, vdekjen...

Nga shkrimet dhe veprat e tij, zbërthehen analizat dhe hulumtimet filozofiko-psikologjike. Kështu, ai u bë edukator i rinisë dhe i popullit. Në vitin 1901,

hapi shkollën e tij personale për të mësuar dhe edukuar sipas metodologjisë së tij, në natyrë, metodën e bashkëpunimit dhe të gjallërimit mes mësuesit dhe nxënësit.

Periodha më e mirë jetësore e krijimtarisë së tij ishin vitet 1909 – 1913, kur edhe bëhet letrar me famë botërore. Ai, në gjuhën angleze përktheu veprën e tij Gitanjali (1913); Universiteti në Kalkutë po këtë vit ia ndau titullin e doktorit të nderit për letërsi, e cila i priu çmimit Nobel për letërsi.

Dy të mëdhenjtë e Indisë

Tagora dhe Gandhi, dy personalitete të mëdha të Indisë, të botës, janë takuar dhe menjëherë kanë njohur njëri-tjetrin në ideale, aspirata, kërkim të Vërtetës, në dëshirë për t'i shërbye Zotit përmes të afërmit, në pranim të Krishtit dhe krishterimit si ilaç i të gjitha plagëve të botës. Nga larg udhëtuan së bashku, secili në mënyrën e vet, si shtegtarë të drejtuar kah amshimi, si dy binare hekurudhore të cilat përplotësohen, ndihmohen, kanë të njëjtin drejtim...

Gandhi kishte njohur, lexuar, studiuar veprat e Tagores, dhe në to kishte gjetur shpirtin krijues e frymëzues për strategjinë e jodhunore. Në anën tjetër, Tagore ishte përkrahës dhe admirues i madh i Gandhit, por shpeshherë edhe shkëmbenin letra me njëri-tjetrin.

Në takim e parë personal të tyre në vitin 1915 Tagore e përshëndet Gandhin me këto fjalë: „Të përshëndes, Mahatma!“ Ky emër, i cili do të thotë Shpirti i Madh në religjionin hindus, i përket vetëm Hyjit, por që nga atëherë Gandhit i mbeti përgjithmonë ky titull nga i madhi Tagore.

Rabindranath Tagore vdiq në gusht të vitit 1941, në moshë të shtyrë, i sëmurë dhe rraskapitur fizikisht, në moshën 80 vjeçare. Me jetën dhe krijimtarinë e tij, u bë dhe mbeti mësues i shumë brezave të shekullit XX, burim i pasur dhe i rrallë i bukurisë së letërsisë-artistike dhe porosisë shpresëdhënëse

Si testament shpirtëror ai na porositi: „Nëpërmjet rrenës nuk mund të arrihet kurrë deri tek e vërteta, sado që ajo të rritet në fuqi... Jeta na është dhënë si dhuratë, dhe ne disi e meritojmë atë vetëm duke u dhuruar... Hyji lodhët vetëm nga perandoritë e mëdha, kurrë nga lulet e vogla... Gjithçka është zëri i Krijuesit i cili flet në heshtje...“

O, Zot, bëj që jeta ime të jetë e thjeshtë dhe e ngjashme fyellit të cilin do e mbushësh ti me muzikë.“



Dom Nosh GJOLAJ
Podgoricë

PUSHIMI DHE UDHTIMI I PROGRAMUAR

Si të programohet pushimi vjetor!

Ende ka njerëz që mendojnë se pushimi i përbashkët i çiftit martesor është luks ose i pakuptimtë - i pavend. Në të vërtetë edhe shpeshherë është i pamenduar pushimi i përbashkët. Pushimi vjetor kërkon në rendin e parë buxhetin e fortë familjar, nëse mungon paraja, pushimi si i tillë mbet vetëm ëndërr e porealizuar për çiftin e ri apo të vjetër, atëherë vetëm mund ta imagjinojmë detin apo bjeshkët. Po ashtu në rendin e dytë e ngarkojnë pushimin e përbashkët: fëmija, posaçërisht nëse është ende i vogël. Por, megjithatë është e nevojshme apo i domosdoshëm pushimi i përbashkët së pakut prej tetë ditëve. Preferohet që çifti martesor, jo vetëm ta programojë pushimin e përbashkët, por edhe ta ndajë në disa etape gjatë vitit (në dy ose në tri pjesë, për me qenë pushimi më i realizueshëm). Çifti martesor ka nevojë për një pushim të përbashkët, siç ka nevojë për bukën e përditshme apo për ajrin e freskët. Sipas përvojave dhe hulumtimeve të bëra në nivel botëror, statistikisht pohojnë nevojën e një pushimit jo vetëm fizikisht por edhe shpirtërisht apo psikik për t'u ripërtëri apo për t'u furnizuar me energji të reja. Kjo është ajo rrugë që çiftit martesor ia thëllon raportet mes tyre, ripërtërihet dashuria që ia ka marrë freskinë rutina e jetës së përditshme, shkarkohen nga ngarkimet e rënda, qofshin ato fizike të punës të përditshme qofshin ato psikike apo mendore, po ashtu pushimi mundëson për ta fisnikëruar karakterin apo temperamentin etj. Atëherë nuk është mirë të lehet pas dore pushimi vjetor i përbashkët por të programohet në mënyrë modestet dhe në mundësit reale që mund të realizohet. Përmes pushimit jo vetëm se realizohet dhurata e dashurisë që dhurohen njëri-tjetrit por edhe njëherë është edhe koha që i shëron plagët, lëndimet, fyerjet dhe po ashtu shkarkimi nga obligimet e përditshme, nga ngarkesat e ditës apo të obligimeve mos të flasim për shkarkimin nga depresionin, neuroza, nga dëshirat e porealizuara, menjë fjalë nga të gjitha ato që e ngarkon çiftin martesor. Pushimi është një prej rrugëve më efikase për t'u ripërtëri jo vetëm fizikisht por edhe psikik ose shpirtërisht, sepse pushimi është ai vendi në të cilin mbushet apo furnizohet "akumulatori i zbrazët" i jetës. Sepse jeta e përditshme paraqet jo vetëm brengat, shqetësimet e llojllojshme, por siç e thamë më lartë edhe ngarkesa të cilat e zbejnë dhe e shëmtojnë ose e çorodisin dashurinë. Për këtë çifti martesor duhet jo vetëm të vetëdijesohet por edhe t'ia krijojnë vetes kushtet për një pushime të tilla. Sepse rruga e përbashkët kërkon



jo vetëm pjekurinë emocionale, ekonomike, sociale, psiko-fizike, por edhe orvatje për ta realizuar ëndërrat e jetës. Siç automobili vetvetiu gjatë udhëtimit të gjatë shtirret dhe fillon të dobësohet, po qe se nuk i bëhet ripërtëritja e domosdoshëm, ai të lë në rrugë dhe del jashtë përdorimit, zakonisht riparimi i tillë është i nevojshme për çdo vit në mënyrë gjenerale. Një gjë e tillë ndodh edhe me çiftin martesor, i cili jo vetëm se ka nevojë për një ripërtëritje shpirtërore, për ta freskuar dashurinë apo për ta ripërtëri fisnikërinë nga rutina e jetës së përditshme, por edhe për ta vazhduar jetën e përbashkët kah qëllimi përfundimtar. Atëherë mos të flasim, se sa, e si, ndikon pushimi i përbashkët për zgjedhjen e problemeve të krijuara gjatë jetës së përditshme, me një fjalë pushimi i mbulon të gjitha dimensionet e jetës së përditshme.

Jeta e përditshme jo vetëm se kalon në mënyrë të vetëdijshëm apo të pavetëdijshëm në vorbullat stereotipi ose monotonisë së jetës, që ia merr jo vetëm frymën e dashurisë, krijimtarisë, imagjinatës, por e lërë të zbrazët dhe steril çiftin martesor, pa ndonjë imagjinatë apo krijimtari krijuese, ose freskuese, relaksuese. Rutina e përditshme është porsiferat që jo vetëm është thumbuesi i dashurisë, mos të themi edhe tunduesi i përhershëm ku ia merr frymën, freskinë, krijimtarinë jetës martesore dhe familjes, e mos të flasim për vdekjen e dashurisë atë pjesë më të bukur të njeriut, që i çon familjet në krizat e llojllojshme deri te divorcet, kanibalizmit i llojllojshëm, dhuna që manifestohet jo vetëm te çifti por edhe te fryti i dashurisë - fëmija. Zakonisht çifti martesor fillon t'i vajtojë kohët e kaluara dhe dashurinë e dikurshme, apo ato ditët e para të dashurisë, të cilat zbehen dita-ditës apo mbeten vetëm në kujtesë, sepse rutina e përditshme atë e tjetëron. Për ta ruajtur dashurinë e freskët dhe frytëdhënëse është e nevojshme, jo vetëm orvatje e pa

ndërpre për ta ruajtur atë që kërkon vullnetin e çeliktë jo vetëm për të punuar kopshtin e dashurisë, por edhe një disiplinë të çeliktë, të cilën së bashku e krijojnë edhe ashtu së bashku e realizojnë ëndrrën e jetës. Ndër të tjera këtu përfshihet edhe domosdoshmëria e pushimit të përbashkët së pakut njëherë në vit, të cilën rregull nuk duhet të harrohet as të lehet pas dore. Dashuria nuk gjendet në rrugë, as nuk bie prej ajrit, as nuk e sjellin recetat e specialistëve, as nuk mund ta blejmë nëpër dyqane apo marketa, po ashtu ajo nuk fitohet njëherë e përgjithmonë, por për të duhet për çdo ditë rishtas për t'u orvatur, për t'u djersitur për ta kërkuar. Për një mendësi të tillë kërkohet nga ana e partnerëve, jo vetëm punë dhe orvatje të përhershme, por edhe pjekuri emocionale dhe motivim për ta fisnikëruar: qoftë karakterin ose temperamentin, qoftë stilin e jetës, me një fjalë dashurinë.

Dashuria duhet të kërkohet ose të gjurmohet çdo ditë, siç kërkon kopshti i luleve kujdesin e përditshëm, po qe se dëshiron të lulëzoj dhe ta japin aromën e këndshme dhe hijeshinë.

Çdo njeri apo individ pas tetë orëve të punës, ka të drejtë në pushimin e natës, siç është fjetja, ka të drejtë në pushimin fizik. Po ashtu pas gjashtë ditë të punëve të javës, çdo individ ka të drejtë në pushimin e dielës, që quhet me tjera fjalë edhe: "dita e princit", që nuk është asgjë tjetër përveç: ditë pushimit, ditë takimit, ditë argëtimit, ditë freskimit, ditë furnizimit, në të cilën ditë mbushet akumulatori i zbrazët i brendisë së shpirtit. Përpos pushimit të dielës, çifti martesor ka për detyrë apo borxh, për t'u kujdesuar edhe për disa ditë pushimit gjatë vitit. Të cilët duhet së bashku për të programuar programin e pushimit duke lënë anash nga karroca e punës së përditshme, ato janë disa ditë dhe net, që rezervohen vetëm për vetëm, që çiftit t'i shërbejnë për t'u ringjall dhe freskuar dashurinë, fatlumturin duke e shkundur pluhurin e rutinës së përditshme e cila jo vetëm se e banalizon ose e bastardon apo çorodit dashurinë por me të edhe çiftin martesor e tjetëron. Këto ditë të pushimit, nuk janë asgjë tjetër, përveç gatishmëria për t'u dhuruara, e, për të qenë të gatshëm ose në shërbim: njëri për tjetrin. Sa i përket nga ana e teorisë një qëndrim i tillë është i mundur. Një pushim i tillë, mund të kalohet edhe në shtëpi, në të cilin rast kursehet shumë, sa i përket shpenzimeve materiale, si fjala bie, udhëtimet e gjatë dhe bujtinat e shtrenjtë kërkon nga çifti martesor edhe xhepin e nxehtë. Për shumë partner një dëshirë e tillë është e pa realizueshme, posaçërisht po qe se në mes gjinden edhe fëmija.

Ndërrimi i ambientit ose i rrethit, jo vetëm se i afron çiftit mundësit për t'u ngritur e për t'u fisnikëruar, por ajo sjellë gatishmërinë solemne, e cila është mjaft e rëndësishme për ta fisnikëruar

dashurinë e për ruajtjen e saj në binarët e normales. Jo vetëm se koha e pushimit i fisnikëron dashurinë dhe atë e ngrit në sferat e larta, por edhe e freskon dhe e ripërtërin me fuqitë e reja, freskuese dhe krijuese, që jo vetëm se e gjallëron por edhe e bënë të mbesin frytdhënëse edhe më tutje.

Po qe se janë fëmija, atëherë si të vendosim për pushimin e përbashkët? Sepse nga ana e nënës kërkon një kujdes së posaçëm për frytin e dashurisë - për fëmijën, të cilin nuk mund të lihet vetëm. Parimisht fëmija nuk mund të lihet jashtë gjirit familjar. Zakonisht prindërit i marrim me veten fëmijët në pushimin vjetor që prapë është mendim apo veprim i gabuar, se ata nuk kanë më kohë njëri-për tjetrin, por edhe më tutje do të vazhdoj rutina e jetës, ata fare nuk mund të shkunden nga pluhuri i monotonisë që sjellë jeta e përditshme, e mos të themi në rastet e këtilla fare nuk furnizohet apo ripërtërihet akumulatori i brendisë, por edhe më tutje ai mbetet i zbrazët pa imagjinatë, jo kreativ, e mos të themi vetëm me atë jehonën që i përsërit vetëm fjalët e vetes, që tingëllojnë në hapësirën e zbrazët.

Në rastet e tilla preferohen fëmija t'u besohet më së miri për një kohë të shkurtër, siç bie fjala: gjyshit apo gjyshes, apo kushërive ose edukatorëve, apo të afërmit të farefisit ose prindërve, për disa ditë. Po ashtu pushimet mos të jenë udhëtimet e largëta, por afër shtëpie, në kufijtë e reales. Nuk është nevoja me udhëtuar larg, si fjala vjen, deri në Havaje dhe me banuar në hotelet luksit. E mjaftueshme është edhe pasioni fshatar, aty në afërsinë tënde, apo vendin ku jeton. Po ashtu duhet t'i shmanget edhe skajit tjetër, siç thotë ai proverbial i vjetër: "Punën, e vetëm punë, për ta ndërtuar shtëpinë!" Një mendësi e tillë është jo vetëm e gabueshme por edhe fatale. Sepse në rastin e tillë, çifti do t'i shtyjë gjithëherë pushimet vetëm për vetëm për të kursyer deri sa ta ndërtoj shtëpinë e ëndrrave. Një shtëpi të tillë nuk përfundon kurrë, dhe çifti i tillë do të plakët, e pasi që ai do të vetëdijësohet, do të jetë teje vonë. Pushimi vjetor nuk mund të barazohet me udhëtimin familjar, sepse nuk i jep ata që e ripërtërin çiftin martesor, nuk mund ta ripërtërin dashurinë dhe fisnikërinë e saj, po ashtu nuk mund t'ia japin freskinë dhe krijimtarinë burimore, e mos të flasim po qe se janë edhe më shumë fëmijë një pushim i tillë mund të bëhet në vend pushimit e riparimit shpirtëror, ngarkesë jo vetëm materiale e financiare por edhe shpirtërore.

Po ashtu pushimi mund të programohet në këtë rast në disa pjesë apo faza të shkurtra. Ashtu nuk ngarkohet nëna, e cila është e lidhur ngushtë me fëmijën e vet. Sepse nëna zakonisht po qe se vendos të shkoi në pushim, e fëmijën ia lërë në kujdesin e tjetri, ajo është e pranishme vetëm fizikisht në

pushim, por me mend janë gjithherë te fëmija. Për këtë ajo nuk mund të përfitojë asgjë nga pushimi vjetor. Po qe se pushimi ndahet si bie fjala tri periudha nga një javë, atëherë ngarkesa është shumë më e vogël se sa ajo që do të zgjasin tri javë të pa ndërprera.

Qëllimi i pushimit është për t'u shkundur nga pluhuri i jetës së përditshme, pluhurin e monotonisë apo të rutinës, për t'i harruar brengat e ngarkesat që i sjellë jeta e përditshme, dhe nga ky këndvështrim, çiftit u jepet mundësia për t'u frymëzuar, për ta ripërtëri dashurinë, për t'u freskuar me imagjinata të reja dhe frymëzuese, menjë fjalë për ta përjetuar njëri-tjetrin, si dhuratë që dhurohet falas dhe pranohet po ashtu falas, kuptohet në këtë rast në dysh.

Po qe se ia bëjmë automobilin për çdo vite riparimin gjeneral, aq më tepër vlen për çiftin martesor, i cili nuk është objekt por në të kundërtën subjekt që kërkon pa ndërpre motivim dhe orvatje, mos të bie në rutinën e ditës dhe ashtu edhe në zhdukjen e dashurisë dhe me të edhe fatlumtaria.

Mos mendoni se pushimi i mirë dhe i programuar së bashku nuk do t'u lërë duarthatë por do të korni suksesin që do të jetë i dukshëm në jetën e përditshme!

Duhet ta kemi edhe një kujdes tjetër, se nuk bënë pushimin vjetor ta zëvendësojmë apo ta barazojmë me kohën e rekreacionit ose argëtimit të cektë. Udhëtimet janë më të çmueshme po qe se e paraqesin shansin e realizimit apo realizimi i ëndrrave të jetës.

Çifti këtë motivim nuk kishte dashur të kalojnë pa e shfrytëzuar, sepse kënaqësitë e përbashkëta sjellin jo vetëm begati të brendshmen por personin e përmbush me përvoja apo mbresa te pashlyeshme, si fjala vjen, pejsazhi i bukur në natyrë, deti i kaltër ose bjeshkët e bardha apo të freskat, qetësia e liqiejve, ose murmurima e pyjeve nga puhia apo koncerti i zogjve, ose prapë përjetimi i muzetë, në të cilat posedojnë vlerat e larta artistike, ose katedralet, koncertet e llojllojshme, pamjet e qyteteve e ashtu me radhë, pushimi sipas shijes së çiftit.

Të gjitha këto nuk mund t'i krahasojmë në mënyrë reale, se sa ndikon në psiken apo në botën e

brendshme të çiftit, jo vetëm në dialog (bisedë) apo në komunikim njëri me tjetrin, por edhe në përjetimin e thellë dhe të papërshkrueshme të botës së brendshme të njeriut, cili i zbulon nga bota e jashtme, nga mjedisi apo natyra e mrekullueshme dhe ashtu ai e përjetojmë në kuptimin e plotë të fjalës dashurinë, jo vetëm si dhuratë e cila nuk zbehet aq lehtë nga kujtesa e pushimit vjetor por edhe si energji freskuese që jep kurajë për ta vazhduar jetën. Edhe pse është koha e shkurtër por kujtesa e përjetimit janë të thella dhe të pashlyeshme, prej nga cilave për shumë kohë furnizohet dhe ushqehet dashuria e tyre.

Kuptohet vetvetiu se gjërat e tilla nuk krijohen rastësisht. Por kërkon nga dy palët ta programojnë së bashku edhe pushin vjetor, duke mos ta humbur para vetes qëllimin e pushimit, sepse është momenti që nuk përsëritet në jetë.

Po ashtu kuptohet dëshirat janë një, dhe realiteti është tjetër, ose njëri ka dëshirat që nuk i përgjigjen partnerit tjetër, si fjala bie, njërit i shkohet në detin e kaltër e tjetrit në bjeshkë e larta me borë, njërit i shkohet gjatë verës, e tjetrit, gjatë dimrit, sepse e preferon rrëshqitje në borën ashtu me radhë. Për këtë është mirë qe çifti të ulet prane tryezes dhe së bashku të gjejnë kompromisin, që të dy palet të jenë dakort, dhe pushimet mos të jenë humbje kohe por furnizim apo ripërtëritje e brendshëm, jo vetëm i shpirtit por edhe i psikes dhe I mendjes.

Po ashtu kërkon edhe para përgatitja e përbashkët, ofhtë ajo e rrëshqitës në borë ose dalja në bjeshkë, ose e lundrimit me vela sipas qejfit, ose prapë për të shkuar në det, si fjala vjen, në Ulqin, Shën Gjini apo gjetiu.

Kuptohet të gjitha këto duhet së bashku të përgatiten. Sa më mirë është përgatitja aq më tepër është ai momenti solemn, të cilën do ta përjetojmë, nga edhe do të thithim ato fuqi ose energji të reja dhe freskuese, që do të ndikojnë jo vetëm në jetën e përditshme, por edhe në sjelljen njëri ndaj tjetrit.

Ashtu rikthehen në mes tjerave edhe kujtimi i të ditëve te para të dashurisë, të cilat nuk zbehen prej kujtesës aq lehtë.



ÇIFTI DHE SFIDAT E KOHËS

Nxitja apostolike “*Amoris laetitia*” (AL) trajton një temë komplekse, të vështirë, por që nuk mund të heqësh dorë, temë e rëndësishme jo vetëm për Kishën, por për të gjithë njerëzimin, ku ngjarja është e populluar nga familje, nga gjenerata, nga histori dashurish dhe krizash familjare, që nga faqja e parë, ku hyn në skenë familja e Evës me Adamin, me ngarkesën e dhunës, por edhe me forcën e jetës që vazhdon, deri në faqen e fundit ku shfaqet martesë.

Mes pyetjeve të shumta dhe problematikave të hasura të dokumentit, dëshirojmë që të ndalemi tek një aspekt në veçanti, që sigurisht nuk i takon një rëndësie të dytë: çfarë mund të favorizojë, nga pikë vështrimi psikologjik, qëndrueshmërinë dhe jetëgjatësinë e një çifti në kohë? Dashuria është thjeshtë çështje e rastësisë, ose e fatit, në varësi të magjisë dhe bashkë me zhgënjimet më të mëdha të ekzistencës, si mund të zbuloj literaturën e çdo epoke? Dashuria a mund të ketë jetëgjatësi përgjatë kohës?

“Dhe jetuan lumtur edhe të gëzuar për një kohë të gjatë”

Muzikali *The Fantasticks* (1960), absolutisht një ndër sukseset më të mëdha teatrore, prezanton një çështje klasike, atë të historisë së dashurisë të të gjitha kohërave (si *Romeo dhe Zhuljeta* – e ripropozuar si një formë teatrale nga komedia po ashtu po aq e njohur, *West Side Story*-, *Tristano e Isotta*, *Paolo e Francesca*, *Pirano e Tisbe*). Është historia e dy të rinjve të dashuruar, të cilët nuk mund të takoheshin si rezultat i ndalimit nga familjarët e tyre, edhe sa më të larta janë barrierat e ngritura nga prindërit për të penguar që ato të takohen, aq më shumë dashuria e tyre rihet dhe gjen forcën për t’i kaluar këto ndalesa. Lidhja, paradoksisht, shkon në krizë, pikërisht kur vështirësitë shfaqen dhe familjet më në fund janë të predispozura që t’i pranojnë.

Suksesi i kësaj dhe prezantimeve të tjera të këtij lloji është e lidhur me kapacitetin e tyre që të shprehin aspekte të përshtatshme të kolektivit të dashuruar, në ideale të tyre dhe në frikërat që provojnë. Nuk është e thënë që përfundimi i çështjes të jetë më tragjikja për çiftin (siç në rasti e *Romeos dhe Zhuljetës*).

Literatura, kur e trajton temën e dashurisë, insiston për më shumë mbi fillimin e tij, dashurimin, deri në fitimin e lodhshëm të të dashurit/ dashurës, por nuk na thotë kurrë se çfarë e

bën dashurinë që të rezistojë në kohë. Vdekja e të dashuruarve, ose përfundimi klasik “dhe jetuan lumtur edhe të gëzuar për një kohë të gjatë”, janë në fund escamotages për të mos përballuar problemin më të konsiderueshëm të një çifti: përditshmërinë, e cila mund të mbuloi edhe dashurinë më të pasionuar.

Ka nga ato që e kanë fantazuar se çfarë mund të ndodhte nëse dy të dashuruarit e tragjedisë së Shekspirit të ishin martuar, duke rënë pre e vjehrrës, e çorapeve të vogla që duhen rregulluar, lodhjes nga puna, kapriçove të fëmijëve... Çështja e tyre sigurisht që do të kishte humbur atmosferën romantike dhe tragjike që e ka bërë të pavdekshme: ato do të kishin jetuar deri në fund dashurinë e tyre të vërtetë, me problemet dhe trishtimin e jetës së përditshme, nga ku vdekja e parakohshme do t’i kishte shkarkuar. Në këtë prespektivë, çështja humb një pjesë goxha të madhe të tërheqjes së saj.



Sfida e jetës së zakonshme

Mësimi që marrim nga këto tregime është se kur çdo pengesë kalohet dhe kur çdo gjë bëhet e mundur, pasioni vjen dhe dobësohet, deri sa fiket. Nxitja apostolike nënvizon rëndësinë e shtyrjes më vonë të dëshirës, në shërbim të një projekti më të madh, në të cilën, përtej pasionit, janë të pranishëm dhe aspekte që bien më pak në sy, që mund ta bëjnë lidhjen më të qëndrueshme dhe të qëndrueshme: Dashuria ka nevojë për kohë në dispozicion, një kohë të papaguar, që vendos të tjera gjëra në planin e dytë. Duhet kohë për të dialoguar, që të përqafohesh pa pasur nxitim, për të bashkë ndarë projekte, për t’u dëgjuar, për t’u shikuar, për t’u vlerësuar, për të riformuar lidhjen. Ndonjëherë problemi është i përbërë nga ritmi i frenuar i shoqërisë, ose nga koha që është në dispozicion të detyrimeve në punë. Ndonjëherë, është problemi se

koha që kalohet bashkë nuk ka cilësi. Bashkëjetojmë vetëm në një hapësirë fizike, por pa i kushtuar rëndësi njëri-tjetrit.

Duke dashur që të japim gjithçka, ndodh që përnjëherësh të dobësohet lidhja, pasi përqendrohemi në aspekte të thella, por të një kohe të shkurtër (si: tërheqja fizike, pasioni), duke i lënë pas dore disa cilësi të tjera, vendimtare. Por ato, për t'u eksploruar në mënyrë të përshtatshme, kërkojnë një kontekst të lirisë dhe mirënjohjes, ku intimiteti i fillimit fillon të gjykohet.

Ky duket se është një nga motivet thelbësore që i motivon çiftet, të cilat shkojnë drejt martesës pas disa viteve bashkëjetese, ato kanë një probabilitet që të ndahen, ose që të kenë pakënaqësi në lidhje me martesën e tyre, një mundësi shumë më të madhe sesa ato që fillojnë të jetojnë së bashku vetëm pas martesës. Është kjo që kërkuesit e quajnë “the cohabitation effect”, duke theksuar se problemi nuk është i lidhur me diferencime vetjake, të temperamentit, ose të vizionit të jetës, por me vetë faktin e të jetuarit bashkë. Kërkimi i një sigurie të tepërt dobëson lidhjen dhe mundësinë e mbrojtjes. Shekspiri e kishte shprehur me një batutë të verbët në tragjedinë “Antonio e Cleopatra”. Kleopatra, e cila donte që të vinte në provë të dashurin (“Nëse me të vërtetë është dashuri, më thoni sa”) Antonio përgjigjet: “Aty edhe mjerimi i dashurisë mund të vlerësohet”. Dashuria vdes atëherë kur provohet që të matet sasia.

Edhe vendimi që të bashkëjetohet, por duke e refuzuar martesën, ose duke e shtyrë për një kohë të papërcaktuar e dobëson lidhjen e çiftit: padyshim rregulli është që gjithsecili mund të iki kur të dojë, duke e lidhur me frikën se kjo mund të ndodh shumë shpejt. Një frikë e tillë përfundon për t'u bërë një profeci e cila do të vërtetohet. Është e vënë re, nga pikë vështrimi psikologjik, kur kemi frikë se një ngjarje do të realizohet, kontribuon paradoksalisht në realizimin e saj. Dhe në fakt, ky tip i bashkimit regjistron një përqindje të shkrirjes, dhjetë herë më të madhe sesa martesa. Supozimi formal i lidhjes, lidhet me një kapërcim të cilësisë duke e krahasuar me ecjen e mëparshme, që nuk mund të programohet, edhe pse elementet që janë edhe më të vogla se profili psikologjik, ndihmojnë jetëgjatësinë e një lidhjeje, e jo vetëm atyre që i jepet një peshë e madhe në momentin fillestar të lidhjes.

Të gjithë kësaj i duhet që t'i shtohen vështirësitë e vetë shoqërisë borgjeze, që e ka bërë martesën një biznes të shtrenjtë dhe stresues, që

kalon në një hap të ngjashëm: përgatitja e radhës për martesë kërkon që të përqendrohen mbi ftesat, fustanet, festën dhe detajet e panumërta, që konsumojnë kursimet ekonomike, po aq sa energjinë dhe lumturinë. Të fejuarit shkojnë drejt martesës të rraskapitur dhe të shkatërruar, në vend që të japin energjitë më të mira për t'u përgatitur si një çift për hapin e madh që do ta hellin bashkë. Ky mentalitet vihet re edhe nga fakti se çifti nuk arrin kurrë në martesë, pasi ato mendojnë për festa tepër të shtrenjta, në vend që t'i japin prioritet dashurisë reciproke dhe formalizmit të saj përballë të tjerëve.

Nga këtu, duket një sfidë e vështirë, por e domosdoshme për shëndetin dhe jetën e familjes, e vendosur përballë shumësisë së propozimeve iluzionare, por edhe ekstremeve tërheqëse: të vësh në dukje se çfarë i lejon çiftit që të kenë jetëgjatësi në kohë, duke i lejuar dashurisë që të kalojë në fazat e vështira e të shumta të jetës.

Çifti si një sistem

Një aspekt fundamental i studiuar nga reflektimi psikologjik është që ta mendosh familjen në termat e një sistemi, në të cilin të gjithë pjesëtarët bashkëpunojnë që të formojnë karakteristikat, në mënyrën aktive apo pasive, duke influencuar reciprokisht. Duke e konsideruar dinamikën e çiftit në brendësi të një sistemi do të nënkuptojmë që të kuptosh se familja nuk është një grumbullim individësh, por një shumësi e strukturuar: është një më shumë, bashkëveprohet, dhe pa këtë të fundit nuk do të kuptoheshin sjelljet e personave tek. Bëhet fjalë për horizontin e referimit: nga mbledhja lindin pasoja që nuk reduktohen në shumën e pasojave të elementeve të marra ndarazi. Praktikisht, është si të thuash se në lidhjen sistematike $1+1=3$, ku elementi i tretë është sistemi, që jep identitetin dhe kuptimin përbërësve tek. Të njohësh këtë hap të rëndësishëm është i domosdoshëm për të ndërhyrë në mënyrë efektive në problemet e çiftit, natyrisht atëherë kur kërkohet.

Elementi vërtetë i rëndësishëm për të përcaktuar cilësinë e lidhjes, nuk është aq çfarë, por si ngjarja lexohet. Qëllimi është që të kritikojmë largësitë e një mënyre spontane, por edhe shkatërruese, të lexohet situata me termat e kundërt, i miri/ i keqi, duke mbetur të burgosur. Një gjë e tillë është nënvizuar në nxitjen: “në çdo fazë të jetës martesore duhet të ulemi dhe të negociojmë sërish marrëveshjet, në mënyrë që të mos ketë fitimtar dhe fitues, por që të fitojnë së bashku. Në shtëpi, vendimet nuk ndodhin në një mënyrë të njëanshme; por që të dy duhet të bashkë ndajnë

përgjegjshmërinë për familjen; por çdo shtëpi është unike dhe çdo sistem martesor është I ndryshëm.

Çfarë ndihmon në stabilitetin e një çifti?

Aktualiteti ekstrem i çështjeve të pranishme në nxitjen “Amoris laetitia”, na tregon një tendencë të shpërndarë nga çiftet që mund të ketë pasoja të rënda për ardhmërinë e jetës martesore. Fatkeqësisht, shumë vetë shkojnë drejt martesës pa u njohur. Vetëm sa janë kënaqur së bashku, por nuk kanë përballuar sfidën e të treguarit se kush janë në të vërtetë dhe të mësojnë se kush është në të vërtetë tjetri. Është situata e bazuar në pjesën më të madhe të historive të dashurisë romantike, ku çifti përqendrohet mbi aspekte të kënaqësisë dhe të tërheqjes, por që zgjasin pak, duke mos i kushtuar rëndësi disa të tjerave më pak të dukshme, por që janë thelbësore për të ardhmen.



Të tilla aspekte janë vënë re nga ato që e kanë studiuar jetën e çiftit nga pikë vështrimi psikologjik. Në një kërkim të zhvilluar me çifte të rinjsh e të rriturish mes 17 dhe 69 vjeçarësh, është vënë re prania e dhjetë zakoneve thelbësore, nga ku rëndësia shfaqet në mënyrë të ndryshme përgjatë kohës. Ato mund të na ndihmojnë që të lexojmë identitetin e mundshëm dhe zhvillimin e lidhjes, pritshmëritë dhe drejtimit e saj.

Rëndësia e këtij pohimi është konfirmuar nga fakti se, përgjatë kohës, elementet më të dukshme të fazës së parë të jetës në çift (aspekti fizik, tërheqja, kënaqësia) përpriqen që të bien poshtë dhe kërkohet prania e parametrave të tjerë, si: besimi, edukimi i fëmijëve, nevojshmëria e tipit ekonomik. Bëhet fjalë për aspekte të cilat nuk kanë marrë rëndësinë e duhur në hapat fillestarë, dhe ngelen anësorë dhe në momentin kur vendosin që të martohen. Mungesa e tyre ndihet gjithsesi në momentet e krizës: jeta bashkë njeh faza të ndryshme dhe kërkon të rimotivosh zgjedhjen e bërë.

Nëse çdo gjë në fillim ishte e thjeshtë dhe spontane, në vazhdim mund të bëhet fryt i vendimeve dhe i punës. Periudha e parë, kur është e pranishme mbi të gjitha bukuria dhe freskia e takimit, është edhe më e përshtatshme për të eksploruar dimensione të tjera – siç ato që nënvizuar më sipër, - në pamje të parë dytësore, por që tregohet se janë të domosdoshme për periudhën e mëvonshme. Të jesh argëtuar bashkë është e rëndësishme, por nuk mjafton që të njihesh, dhe kjo mungesë njohjeje do të tregojë efektet e saj më vonë, kur do të kërkohej baza të reja për të forcur lidhjen.

Për arsye hapësire limitohemi që të komentojmë zakonet më të rëndësishëm për të ruajtur shëndetin e çiftit përgjatë kohës: të dëgjosh, si shprehi e komunikimit intim.

Bëhet fjalë për një zakon kaq të rëndësishëm, shumë të mundimshëm dhe të radhë në nivelin edukativ, por që gati kurrë ne nuk e bëjmë. Por dëgjimi është i pazëvendësueshëm kur bëhet fjalë për cilësinë e lidhjes: një dëgjim i kujdesshëm, empatik, i aftë që të pranojë dhe kjo mund të japë rezultate të mëdha për të njohur dhe për të ndihmuar tjetrin, duke i bashkë ndarë momentet më të rëndësishme. Kjo nuk ndodh vetëm me çiftet. Kush është shënjuar rëndë nga jeta, për arsye sëmundjesh, ose invalidët, është vënë re se takimi me personat e tjerë që janë të aftë për ta dëgjuar me kujdes dhe dashuri, ka ndryshuar radikalisht mënyrën e të vështuarit të gjërave. Të dëgjosh, është e vështirë, pasi kërkohen motivacione të forta, veçanërisht disponibilitetin për të humbur kohën me tjetrin/ tjetrën. Punët profesionale nuk paraqesin ndonjë pengesë, nëse është krijuar një lidhje e bukur dhe e papagueshme; madje ajo është një stimul për të zhvilluar më mirë aktivitetet e veta: “kur sukcesi në punë me bashkëshortin do të bëhet një nevojshmëri kategorike sa ç’ është edhe sukcesi në karrierë, nuk do të pyetesh më: si ia bëhet që të gjendet koha? Do të dijë sesi ta bëjë. Kjo është diçka që çiftet e lumtura e kuptojnë më së miri. Nuk mund t’i kthejmë pas mbrëmjet e kaluara me persona që nuk na interesojnë, ose që nuk na interesojnë aq shumë sa personi që dashurojmë, për t’i jetuar tashmë me atë, në një mënyrë tjetër. Çiftet e lumtura e dinë që i gjithë gëzimi është “tani, ose kurrë më vonë”. (Vazhdon në numrin e radhës).

Përktheu: Bernardina Shahini

Material i përkthyer nga revista kulturore – fetare Giovanni Cussi S.I. “La civiltà cattolica”, 2017.


**PATER ANTON HARAPI:
PSE U BANA PJESE E KËSHILLËT TË NALTË TË REGJENCËS!**

Sapo ka dalë nga shtypi vepra e At Anton Harapit “Naltimi i ndërgjegjes kombtare”, Botime Françeskane Shkodër, 2017. Vepra përmbledh të gjitha shkrimet në prozë të At Anton Harapit botuar në revistën “Hylli i Dritës”. Janë vënë edhe disa shkrime të At A. Harapit botuar në gazetën “Ora e maleve” 1923-1924. Prej këtyre shkrimeve përzgjedhim për botim rrëfimin e tij, që hedh dritë mbi pjesëmarrjen e tij në Regjencë, së pari- sepse çështja ka qenë dhe është e debatuar (pse kleri u përzje me ‘qeveritë kuislinge’), dhe së

Këshillit të Naltë, Mehdi Frashërin, Lef Nosin, Fuat Dibrën dhe Padër Anton Harapin. Ky i fundit asistoi në të gjitha mbledhjet e zhvilluara me praninë e Këshillit të Naltë, porse u betua më 13 janar 1944 pasi kishte marrë edhe lejen e Papës.

Një sqarim hyrës nga “Hylli i Dritës”

Kur asambleja kombtare një zani lypi qi në Këshillin e Naltë të Regjencës të figuronte edhe persona e P. Anton Harapit, shumë kush u gëzue, s’kje kush qi tha se ai nuk e meritote atë rangë aq të naltë. Por ndër ata qi nuk u gëzuen për këtë punë



dyti se shumë kohë pas vdekjes, e ka të drejtën e fjalës- një shpjegim i tij pse u bë pjesë me lejen e eprorëve dhe si nismë personale.

Lindi më 5 maj 1888 në Shirokë, studioi në Austri, botoi disa vepra, qe pjesë e grupit opozitar me Luigj Gurakuqin. Me instalimin e regjimit, mbas disa kërkimesh, komunistët e gjetën. Për gati gjashtë muaj qëndroi në birucat e hetuesisë, në Tiranë, nën tortura. U pushkatua natën e 14 shkurtit 1946, në orën 18:30. Eshtrat e tij, kalbur në një gropë të panjohur, në rrethinat e Tiranës, vijnë në presin një varr. Më 25 tetor 1943, Kuvendi Kombëtar zgjodhi si anëtarë të

kje edhe P. Antoni vetë. Në një kohë në të cillen “të ndershmit”, kërkoshin me u strukë, me e ‘ruejt vetin’ për një kohë tjetër më të mirë, në një kohë shpartallimi t’plotë t’auctoritetit shtetnuer, në një kohë kur, me pranue një zyre të tillë dote me thanë me vû vetin shëj pushke mënës së shumëkuj e fjalëvet të gati gjithkuj, lypej zemer e guxim me i përgjegjë apelit t’Atdheut, qi i lypëte ndihmë. Por miku i mirë njihet në ditë të ngushtë.

Rrëfimi

Tash sa kohë publiku shqiptar ka pritë me ndie një fjalë prej meje. Megjithëse parashoh se do të kuptohem keq dhe do të komentohem ndoshta

edhe mâ keq, due t'i a çoj në vend dishirin: due t'a thom fjalën t'eme. Por, vall, shka të thom, kurse me fjalë jemi ngi? A kemi kund ndonji punë të mbarë, pse sa per fjalë të bukura nuk jemi ngusht aspak?

1 – Ja, pra, se një punë e mirë u ba: mbas sa muejsh anarkije, sa të frikëshme aq edhe të rrezikëshme, sot – mirë a keq – kemi një Këshillë të naltë, kemi një Parlament, kemi një Qeveri, kemi një auktoritet shqiptar. Ketë vepër dikush e shikon me sy të mirë e dikush me sy të keq, aq sa edhe miqë e dashamirë të mij mrrijtën: Shka i u desht Patër Antonit me i a hy kësaj pune? Këtyne due t'i u përgjegji, jo si zyrtar, por si mik, jo për të përligjë vehten, por për të ndritun mendimin t'em dhe të tyne.

Më rrenë mendja se nuk ka zog shqiptari, qi të mendojë se unë e mora ketë barrë për kulltuk, për interesë a për ndonji intrigë. Mundet veç me dashtë ndokush mos qe ndonji maní e emja qi më shtyni deri këtu. Edhe unë po u a vërtetoj fjalën dhe po u thom se po: manija e Shqipnis, po, qe ajo qi më vuni dilemën: a me anarkista për të ba gjak, ase me hjekun dorë prej çashtjes kombtare. Dhe mbasi shpirti nuk m'a tha të baj as njenën, as tjetrën, qeshë i shtrënguem të zgjedhi njenën dysh: a të baj një marrí tue e pranue ketë zyrë; ase të tregoj një dobsí tue u largue. Vendova ma mire të baj një marrí: ase – sikurse thonë ata shqiptarë qi duen të ruhen të pastër – desha të kompromentohem.

2 – Ja arsyeja për të cilën pranova të marr pjesë n'auktoritetin shqiptar: pse nuk muja t'a shoh Shqipnin n'anarki. Në këtë kohë dhe ndër këto rrethana, për né Shqiptarët anarkija asht një turp dhe një delikt: po, turp asht të ngatrohemi shoq me shoq dhe vetë të krijojmë Babylonín shqiptare, pa qenë të zotët t'i a gjejmë fijen lamshit; delikt asht në ketë moment kaq kritik për botën mbarë të vejmë për ideal vllavrasjen, përmbysjen e katundevet, humbjen e gjas dhe shkatrimin e familjevet. Kësaj i thonë rrokoll më rrokoll! Pra, m'u dhimbt populli e m'u dhimbt Shqipnija.

3 – Maní... E po, si kujton Pater Anton Harapi se ai po e shpëton Shqipnin?! ... Jo, zotní! Asnjeni nesh, qi kemi marrë zyrën e Këshillit të Naltë, nuk e kemi pretenzonin të mbahemi shpëtimtarët e popullit. Dhe atëherë, pra?... Shqipnin do t'a shpëtojë Zoti, kurse na i kemi vu vehtes një

misjon: të përpiqemi me të gjitha fuqit për t'a pakësue mjerimin dhe shemtimin shqiptar. Na e kemi ndërgjegjën të kjahtë se jemi njerëz nevoje, d. m. th. se vetëm nevoja e kohës na ngrehi në ketë shkamb; as nuk kemi fjalë të mdhaja dhe premtime të bukura, por, po mujtëm t'i a lehtësojmë popullit sado pak ata shka vuen, dhe po mujtëm të vejmë një gur të vogel për konsolidimin e çashtjes shqiptare, do të jemi të lumtun.

4 – Përveç këtij misjoni, një tjetër arsye e fortë më shtyni t'a baj ketë hap: Qaje, Zot, të keqen – thashë me vehte – si mos me u gjetun në Shqipni burra të zotët, qi të marrin përgjegjësi publike dhe të mos fllojnë vehten për kolektivitetin?! Mospranimi i bashkëpunimit në ketë rasë – me e shikue hollë- për mue do të kishte qenë një spekulacion: unë, i grishun botnisht të jap kontributin t'em për çashtjen e kombit dhe për ndihmën e popullit, ma parë do t'anojshem të ruej kryet dhe prestigjin t'em personal, se sa me rrezigue vehten për çashtjen e përbashkët. Anishka – thashë – rroftë populli edhe pa mue, rroftë Shqipnija!

5 – Edhe komunistavet due t'u a tham një fjalë, por kjahtë e shkurt. Unë jam i bindun se pak janë ata Shqiptarë, të cillët vërtë e kuptojnë doktrinën komuniste, por, tashmë të gjithë po e shohin dhe po e njohin organizatën dhe vepren komuniste në Shqipni. Kjo është e vertetë, e kjo don me thanë se gadi të gjithë komunistat shqiptarë veprojnë me krye në thes pa dijtë shka bajnë dhe për shka veprojnë.

Por, po thonë se e kanë per Shqipni, e vetëm per Shqipni. Unë due t'u besoj, por ky dallim midis doktrinës komuniste dhe veprës komuniste me formën kombtare – sikurse i kam ndigjue unë dhe vetë tue dishmue organizatorët komuniste – mue më ban me dyshue për sinqeritetin e kësaj rrymë Shqiptare: Pse, vall, komunistat veshen e ngjeshen me zellin atdhetar, kurse atyne mbi të gjitha u intereson doktrina e jo atdheu? Masat terroristike, mandej, vllavrasja, lidhnija e ngushtë deri në dependencë të plotë prej dorës së huej, dhe përdorimi i çdo mjeti për qellim nuk i lanë vend dyshimit. More, me kubure në gjoks nuk bahet kush as vllá, as shoq, por ja skllav, ja mizuer apo hypokrit...

Gjithëmonë tue rrënue, nuk ndërtohet.



Gjovalin Muzhani
Trieste

NËNA SUPERIORE PROVINCIALE KONSILE MUZHANI

Përkujtojmë me respekt 125 vjetorin e lindjes së Nënës Superiore Provinciale, Konsile Muzhani, 40 vjet Nënë. Jetuan bashkë me motrën, Nënë Veronika Muzhanin, që e përkushtuan jetën si bijat e Zojës së Shkodrës. Ishin bashkudhëtare me Nënë Terezën, qenë kushërira të largëta...

Lindi në qytetin e Shkodrës, më 17. IX. 1892. Ishte vajza e Mikel Muzhanit. Në familje quhej Antone Mikel Muzhani. E vogël që mjaft e urtë, e sjellshme, e vëmendshme, inteligjente, e gjallë, tejet e ndershme, e gjindshme për të gjithë, shumë punëtore. E pakursyeshme për të gjithë, duke iu shërbyer me përvujtëri. Prindërit e donin shumë, se ishte e zgjuar, sjellshme, e bindur e dëgjueshme dhe serioze në sjellje. Prindërit kishin besim e shpresa në zotësinë e saj. Në shkollë mësonte shumë, si e para në mësim që ishte, merrte vazhdimisht nishane e lëvdata nga shkolla. Ndihamonte motrat në mësim, pati devocion deri në përvujtëri në rrugën e bijave të Zojës Stigmatine.

Në rrugën e saj plot adhurim për fenë, i dha shumë ndihmë të madhe tezja e saj e mirë, e mençur, Motër Benina Leci dhe i vëllai Gjoni, që vdiq në lulen e djalërisë, 18 vjeç, me dëshirën e përzemërt për t'u bërë meshtar i Jezuit. Motër

Benina, murgeshë me mjaft kulturë, kreu shkollën e lartë në Firence dhe jepte mësim lëndën e Edukimit Fetar, ajo që Nëna Superiore në Jetimoren e Firences.

Një natë, ashtu të mbledhur rreth vatrës, gjatë dimrit të ftohtë, në mes të prindërve, të motrave dhe vëllezërve, mori guximin, e prirë nga Zoja e Shkodrës, të shfaqë mendimin për të hyrë në Kuvend të Murgeshave Stigmatine, si rregulltare. Vendosi që të heqë jelekun e brandavekët e vajzërisë shkodrane, duke i veshur petkat e thjeshta të përvujtërisë së probandës, për të hyrë në Kuvend të Murgeshave Stigmatine. Gjithë familja nga përmallimi u preken aq shumë e pa dashur u zhgrehën në vaj prindërit e motrat, që aq shumë e deshën... Së bashku, e gjithë familja thanë rruzare, për lumturimin e rrugës së saj, e cila ishte e bindur në rrugën me devocion ndaj Zojës së Këshillit të Mirë.

La rrugën e shekullit plot punë, nënën, babin, vëllezërit e motrat që aq fort i deshi, e duke lënë në pikëllim më të voglën, Metildën (Tilën) 3 vjeçare. Braktisi pasurinë e mirëqenien familjare të Mikel Muzhanit, s'i mungonte asgjë për të kaluar një jetë vorfënore kuvendi, për lumturi të të madhit Zot, si bijë e Zojës së Këshillit të Mirë. Hyri në Kuvendin e Murgeshave Stigmatine, në lulen e rinisë, në 18 pranverat e jetës vajzërore. Familjen Muzhani, si vendbanim, vetëm një mur i ndante prej Murgeshave Seleziane. Kjo bijë kishte lindur më 17 shtator, ditën e Shën Françeskut, më vonë për tu bërë, rregulltare stigmatine. Shkollën e ulët fillore e ndoqi në Stigmatinë, dhe aty mësoi shkëlqyeshëm, duke dalë me rezultatet më të larta, duke dalluar nga shoqet ajo e tërheq vëmendjen e mësuesëve eprore...

Motra eprore, Stigmatine duke e parë se kjo probandë ka vijimësi të lartë shkollore e sjellje shembullore të devotshme për fe të krishterë, e zgjodhën për ta dërguar në Itali për të bërë studime në universitetin e Firences dhe pastaj në Romë, e cila u diplomua për profesoreshë në Teologji e Matematikë. Doli me rezultate të larta, erdhi në Shqipëri me përkushtim në punë si murgeshë. Dha mësim në Normalen e shkollës Stigmatine, në klasat e larta superiore, lëndën e Matematikës dhe



mësime fetare. Ishte profesoreshë shumë e rregullt, serioze në përvujtëri, njohëse e lëndës e me kulturë poliedrike.

Zotëronte mirë gjuhën italiane, frënge, latine, greke dhe serbe. Gjatë punës së saj si profesoreshë, edukatore e rregulltare shembullore, zgjoi vëmendjen e murgeshave eprorë, u zgjodh Nënë Superiore Provinciale, pasardhëse e Nënës Superiore Provinciale, Feliciane, e cila që një italiane shumë e nderuar. Qe thirrur në Romë në instancat e larta të Stigmatineve, e cila mori kushtet e Nënës Superiore Provinciale, për Shqipërinë. Ajo që zgjedhur tri herë radhazi në krye të çdo tre vjetëve Nënë Superiore Provinciale, këtë titull nderi do ta mbajë nga viti 1935 e në vazhdimësi, deri sa vdiq në vitin 1975. Për 40 vjet udhëhoqi në vitet më të vështira të persekutimit të fesë nga diktatura ateiste..

Gjatë punës si drejtuese në Kuvend, kishte formuar personalitetin e saj dhe shprehu aftësitë drejtuese pedagogjike-mësimore. Drejtoi institucionin e Stigmatineve me urtësi, drejtësi, mirësi dhe seriozitet, në harmoni e bindje ndaj rrugës së Zotit. Sikurse thoshin motrat rregulltare për të: “Ishte e vetmja organizatore në punë, ajo vetë ecte e para, kishte drejtësi, urtësi e zgjuarsi, fjala e saj që bindëse, e saktë, dhe vendosi në Kuvend një disiplinë bindëse, të moralshme e të vetë ndërgjegjshme”.

Mbi 70 motrat Stigmatine e probanda që i drejtonte, e nderonin e respektonin dhe ia kthenin respektin e ndërsjellët që kishte ajo si udhëheqëse. Ishte dhe provinciale që kishte në juridiksion e kontrollonte që në Lezhë, Tiranë, Korçë dhe deri në Vlorë. Mbante përgjegjësinë morale të edukimit të mbi 350-400 vajzave të moshave të ndryshme, ku vinin vajza nga të katër anët e Shqipërisë, që i përkisnin besimeve të tjera. Me aftësitë e mira pedagogjike që i kishte, drejtonte të gjithë kategorinë e shkollës, duke i caktuar njerëz të veçantë në detyrat më të përshtatshme, që puna të ecte mjaft mbarë, në harmoni dhe korrektësi. Nënë kishte përgjegjësinë morale për frekuentimin.

Drejtonte rregullin, disiplinën e regjimin ditor të brendshëm, përgjigjej për ngrënien, higjienën, rregullin e përpiktë, për përshtatshmërinë. Orvatej të drejtonte me drejtësi e seriozitet, mirësi, harmoni kolektive posaçërisht edukimin moral të fesë së krishterë. Vajzat merreshin me edukimin shkollor më të mirin, mësonin: shqip, frëngjisht, italisht e latinisht, njohuritë shkencore, nxënëset e Normales përvetësonin edhe ekonominë

shtëpiake, duke fituar profesionin e rrobaqepëses, punës së dorës, qëndistarisë e pikturës.

Mësonin pikturë, muzikë dhe një instrument muzikor të nevojshëm për mësueset e ardhshme. Edukoheshin në mënyrë të përkryer me mirësjellje e përvujtëri të përshtatshme për fenë, në adhurim për Zojën Hirplotë. Nxënëset, që do jenë nënat e ardhshme, do edukojnë fëmijët e tyre me dashurinë për Fe-At dhe moral të lartë të krishterë. Shkodrani kishte shprehjen që thoshte: “Vajzë e urtë, e sjellshme, e mirë, si me u pasë rritë ndër murgeshat Stigmatine”.

Qe nismëtare e shkollës Normale Stigmatine në drejtimin e Nënës Superiore, Konsile Muzhanit, ku dolën kuadrot e para të mësueseve të ardhshëm, 5 breznitë, si shkollë e parë Normale në Shqipëri. Qenë mësueset shembullore shkodrane, që u quajtën metodiste, e lënë në harresë, si nëna të përvuajtura, të nderuarat murgesha stigmatine. Ja si i vlerësoi Atë Gjergj Fishta:

...Edhe i shkollë besa lum Zana,
...Eni pra vajza shkodrane,
Qi danë n'shej, n'Shqipni ndër tana
S'ciles fe s'cilës stinë,
Po ish ajo shkolla femnore,
E t'brohorasim n'nderë kësaj nane
Qi n'at Shkodrën mizore,
Rrofshin shkollat Stigmatine...
Stigmatinet çelë e kan,
(Atë Gj.Fishta: Mrizi Zanave)
Mbas programit Françeskan...

Kishin në mbikqyrje Kishën e Murgeshave Stigmatine të Zojës së Papërlyeme, që në funksion të saj kishte pastërti, dritë, lule e rregullsi; që një pasqyrë vërtetë tejet shembullore..

Kori i bukur i Bijave të Zojës ishte mjaft i mirë, i përbërë nga 40 vajza të zgjedhura për kanto. Këndonin plot devocion, meloditë e bukura, të ëmbla e të harmonishme kishtarë e patriotike. Shkolla kishte grupin teatral shumë të mirë në interpretim, spektatorëve iu linte mbresa...Grupi i valleve, shoqërohej me korin e orkestrën shkollore. Shfaqjet për festa e kishin hyrjen pa pagesë, me ftesa. Ndiquej programi me interes e kënaqësi nga spektatorët, familjet e nxënësve. Me iniciativën e Nënës Konsiles formuan biblioteka mbi 500 blej (copë) e 500 artikuj, shpejt duke u pasuruar në vazhdimësi.

Lëmoshat e mbledhura në Kishën e Zojës së Papërlyer, që jepnin adhuruesit besimtarë, ishte si

rregull që të dërgoheshin në Romë. Nënë Konsilja bëri kërkesë atje e mori miratimin: Këto lëmosha t'u përdoreshin për të varfrit e qytetit duke krijuar mjaft fushata bamirësie. Kuvendi i Murgeshave blinte pëlhura, basma e leshra ndër tregtarët që favorizonin më lirë blerjen. Kuptohet Famullitari Mikel Muzhani jepte ndihmën më të madhe në falje, se kishte dy bija murgesha.

Këto pëlhura i qepnin kotulla në kuvend, nën drejtimin e profesorehave, duke ia mësuar rrobaqepësinë nxënëseve të Normales. Bijat e Zojës bënin punën e dorës, me mirësi si: shtroje të vogla tavolinash, punime të bukura me grep etj. Punonin me leshra të ndryshme xhupa e bluza me shumë shije, të bukura. Të gjithë këto punime ekspozoheshin në raste festash, si: Pashkë e Krishtlindje, dhe mbas dy javësh faleshin ndër familje të varfra në bamirësi. Shuma për të gjitha bamirësitë në disa vjet arritën deri në 12 600 franga arit. Kjo qe vërtetë një vlerë e madhe bamirësie...

Me vendosjen e regjimit komunist në Shqipëri, që në fillim Kuvendi i Murgeshave pati mjaft trazime. Shtrëngesa, tundime dhe kërcënime të vazhdueshme... Me besim në Zojën e Këshillit të Mirë, me durim e shpresë diti t'u dalë në krye punëve me urtësi, drejtësi e kurajë, duke përballuar me shumë vështirësi mungesat e peripecitë në këtë Kuvend, pa të ardhur me një varfëri të plotë murgeshat e probandat!... Kurrë nuk u ankua Nëna Konsile, as në familje të vëllezërit, që edhe atyre (familjareve) iu nisi rrapresalja e madhe, shtetëzimi i krejt pasurisë. Me ndihmën e të madhit Zot, durimit dhe shpresës, pas një seri sakrificash, ia priu Zoti mbarë dhe e drejtoi me ndere deri në fund të jetës, duke përmalluar me vështirësi ateizmin fetar, në përndjekje të përhershme të rreptë të diktaturës

Në vitin 1946, Satani (djalli) i kuq ia mbylli Kuvendin e shenjtë dhe shkollën, duke i lënë në rrugë të madhe nxënëset, probandat e murgeshat Stigmatine!... Nëna Superiore, Konsilja dhe pse qe jashtë Kuvendit, me kurajë, urtësi dhe durim, i jepte porosi e udhëzime tejet të kujdesshme. Të gjitha e respektuan për të parën e tyre udhëheqëse dhe ilegalisht orvateshin në mënyrë klandestine secila të kryente detyrën e vet si të ishin në Kuvend. Pak motrave Stigmatine iu lejua punësimi në spitalin civil të Shkodrës, që me kursimet e tyre ndihmonin motrat plaka, të pa puna e të dobëta. Pra, filloi rruga e mundimeve e Motrave Stigmatine, e frikës, e vuajtjes, e sakrificës...

Në lëvizjen opozitare të Posttribës 9. IX. 1946,

kundër regjimit komunist, u bë gjakderdhje e madhe, qe një luftë e pabarabartë, masakra që u bë qe e pamëshirshme. U vranë dhe u plagosën nga të dyja palët, të cilët u shtruan në spitalin civil të Shkodrës, të mbushur përplot. U kërkuan infermiere shërbimi, këtë shërbim sanitar e kryenin motrat Seleziane. Nëna Konsilja me iniciativën e vet zgjodhi 10 motra Stigmatine për t'i shërbyer të plagosurve në spital. Murgeshat kishin ndrojtje për të dalë nga Kuvendi në atë kohë, sepse fyheshin nga monistët anti fe. Me drejtësi e bindje caktoi motrën e vet, të parën, Motër Veroniken, mandej vajzën e tezes, më të renë Motër Vitore Lecin etj.

Me vullnet e kurajë punuan motrat në mënyrë shembullore në shërbim të të plagosurve më të rëndë, duke pasur dorën e Zotit mbi kokë. Nënë Konsilja nuk mbante me hatër e favore motrën e vet Veronikën, atë e caktoi drejtoreshë të vetmuar në fshatin Dajç, Shirokë, Tiranë e Korçë. Tregonte Motër Veronika: "Shkova me detyrë në Dajç, nuk kishte as orë për të drejtuar shkollën. Më vinte turp që t'ia kërkoja Nënës Superiore. Në konfidencë iu drejtova vëllait Ndoc Muzhanit (babait tim), i cili hoqi nga xhepi i jelekut orën e vet "Omega" me zinxhir ari, që e kam ruajtur deri në fund të jetës, se punonte mirë".

Porsa u mbyll Kuvendi i Stigmatineve, ndër ma të rregulltit në Shqipëri, ajo deshi të punësohej për shkak të varfërisë ekonomike dhe si vend më të përshtatshëm menduan në spitalin civil, së bashku me të motrën, Veronikën. Të dyja infermiere me shkollë të kryer jashtë. Nuk i jepnin punë, me justifikimin se jeni të familjes së prekur tregtare të Muzhanve, që i pinë gjakun popullit!

As Këshilli i lagjes nuk i jepte punë, as Komiteti Ekzekutiv. I caktonin punë të rënda krahut, si për të shkuar përditë në fshat 2-3 orë larg në bujqësi dhe punëtore rruge për t'i poshtëruar!... Këto dy motra shembullore, që lanë kushtet familjare, që në rini kaluan një jetë të varfër në Kuvend, të dyja të diplomuara Nënë Konsilja në Firence e në Romë, dhe Motër Veronika në Vjenë, dy profesoresha shumë të afta të shkollës Normale. E çfarë të keqeje do t'i sillnin sistemit monist, motrat stigmatine, që të vendoseshin në një punë të përshtatshme tani në pleqëri? U këshilluan me vëllezërit, edhe u sistemuan provizorisht në familje të Zef Muzhanit, ku e kishin dhe nënën e vet shumë të sëmurë.

Dy të bijat, murgesha, i bënin shërbim shembullor nënës. Sa i vdiq e ëma vëllezërit ishin

në burg për tatim dhe vajzat kërkuan me këmbëngulje, në shenjtërinë e tyre, të jetonin larg familjes, për të bërë një jetë rregulltareje. Shkuan për të gjetur banesë, se frika ishte e madhe për t'i strehuar murgeshat, dhe me zor gjetën një shtëpi shumë të vjetër e përdhese si kasolle, në afërsi të Kishës së Arrës së Madhe të Zojës Rruzare.

Këtu jetuan si vetmitare në periferi të qytetit si fshat, rreth vitit 1953. Ishte një shtëpi shumë e vjetër, e vogël si kolibe, prej dërrase e çaklash, si qëndronte në këmbë?!... Frynte era në të katër anët, gjithë plasa, si qëndronte pa u shembë?! Porsa hipje në 5-6 shkallët nga oborri për të hyrë në dhomë lëkundshin thua se kur po thyhen. Dërrasat e dyshemesë të hapura, gjysmë të kalbura shtinin erë të ftohët. Tavani i hapur ndër shumë vende,



shtinte erën dhe shiun. Muri çaklash i patën riparuar me kartonë e fibra, por era dhe te ftohtit depërtonte në të katër anët, si një kasolle e ftohët e akullt...Kur frynte tufani kishe frikë se po e rrëzon...Kur binte shi nuk kishe vend ku të mbroheshe e ku të ndizje një furnelë të vogël me vajgurit, pa le se ku të flesh...Ndër netët me shi me rrëshekë, në hapësirën e dhomës 3x4=12m² dhe porsa binte borë, pesha e saj mbi çati, rrezikonte të shembej!

Ta imagjinoni këtë dhomë kolibe kur vërshoi lumi i Kirit, uji arriti në afërsi të dyshemesë. Natën e datës 7. II. 1973 qe vërshimi më i madh i lumit Kir, lartësia e ujit arriti 1.5 m. Dhe në mesnatë arriti 2 m, duke dalë mbi dysheme të dhomës 30 cm. Uji i rrëmbyeshëm vërshonte me vrull si lum, në vorbullën e vet teje të vrullshme e të frikshme, thua

po të përpin e të merr me gjithë shtëpi...

E gjithë shtëpia lëkundej si barka në tallaz të rrymës së tërbuar ujore. Tmerroheshe duke parë gjithë natën vdekjen me sy... Hipën ndër dy karrige e herë sipër shtratit, dy motrat Stigmatine i luteshin Zotit me devocion e rruzare për t'i shpëtuar...Zoti e bëri mrekullinë e vet, mbas mesnate, në orën 3, uji shpërtheu vrullshëm tek muri i një oborri aty afër. Niveli i ujit erdhi duke rënë...Nga lagështia dhe të ftohtit duart e tyre, pa ngrohje gjithë dimrit, morën sëmundjen e reumatizmit të fortë, duke ia deformuar gishtat e duarve me morth e gjakosjen e tyre. Asnjëra motër s'u ankonte, i ruajti Zoja Hirplotë se qenë bijat e saja. Nën kujdesin e tyre mbajtën Kishën e Zojës Rruzare, duke i shërbyer në mënyrë shembullore,

deri kur e mbylli shteti ateist Kishën e fundit të fretërve të Arrës së Madhe, në Shkodër.

I vetmi ngushëllim për to qe se banonin pranë komshinjve të mirë, familjes së nderuar të Ernest Nikaj dhe e shoqja, një grua e rrallë, që shprehi mirënjohje të paharruar, se iu gjetën pranë. J e t e s ë n varfanjake të tyre, pa pension e pretendime, e nxirrnin duke punuar ditë e natë me duart e arta që kishin, por paguheshin sa për

lëmoshë. Njerëzit s'i harronin dhe nxënëset i përkujtonin në respekt të thellë. Kaluan një jetë si skamnore, me rruzaren në dorë. Bënin kurse me sakrificë, duke ia hequr gojës së tyre për t'i ushqyer të varfrit e priftërinjtë e pa asnjë ndihmë. Bijave të varfra, qytetare e fshatare, iu qepnin rrobat dhe pajën e nusërisë, pa asnjë pagesë. Paret e kursyera me njëmijë sakrificë ia çonin priftërinjve të burgosur, që vuanin e s'kishin asnjë ndihmë...Edhe të sëmurit i ndihmonin me ilaçe, ndihma dhe me shërbime...Vetë dora e Zotit ia mbajti shëndetin e frymën, duke jetuar në atë kasolle të ftohët si të ishin jashtë nga të ftohtit, të mbrojtura pak nga shiu, ...si jetuan mrekullisht 30 vjet!

Me datën 29. VII. 1975, pasi lëngoi për disa javë nga pleqëria, Nëna Superiore Konsilja vdiq në

moshën 83 vjeçare në varfëri dhe në mjerim si në ferr, por pati mirësinë motra e saj, e tejet e përvuajtur, Veronika, e cila i qëndroi mbi kokë duke i bërë një shërbim tepër shembullor si rregulltare-infermiere, me përshtirshmëri jo vetëm si motër më e madhe, por si Nënë Provinciale e Stigmatineve.

Ndër ditët e fundit të jetës, familja Muzhani i erdhi përreth me nipa e mbesa pranë. Ditën e ceremonisë së varrimit kishte një pjesëmarrje të gjerë, njerëzit do të hynin me rrallë në dhomë, se mos të shembej dhoma. Iu bë një funeral i nderuar me të gjitha respektet fetare e familjare. Sikurse e kishte lënë me porosi, që të mos i bëhen kurora me lule e ceremonira, si jetën që e kaluan të përvuajtura në thjeshtësi, këmbëzbathur si fretërit, pa ngrohje. Kurorat me lule janë për Zojën Hirëplotë.

U largua me uratë e lutje për në lumturimin e Parrizit. Vdekja e Nënë Konsiles e pikëlloi krejt fisin, dhe të gjitha motrat Stigmatine dhe nxënëset, të cilat e përcollën me pikëllim dhe rruzare. Posaçërisht e pikëlloi në varfërim motrën e saj fort të dashur, Veroniken, duke jetuar e vetmuar, e cila jetoj edhe 5 vjet të tjera në këtë dhomë plot punë me shqetësime! Kjo, në dy vitet e fundit të jetës, erdhi duke u fikur si kandili pa vaj. Kërkoj mbështetjen e familjes Muzhani. Unë desha ta marr në një dhomë në vete, të vogël, ku kishte banuar 10 vjet, fort e nderuara Motër Kristina Noga. E refuzoi, se kishte paksa lagështirë, mbasi e kishte mbuluar reumatizmi. I vetmi kurim i saj që merrte qe 4 aspirina në ditë!

Atëherë u gjet bamirësia e Angjelin Muzhanit me gruan Marta, që e morën në shtëpinë e tyre, në mirësi e përkujdesje shembullore. Nipat e mbesat ia lidhën si një farë pensionit duke kontribuar së bashku, pasi shteti i kishte lënë qëllimisht në harresë, pa pension këto motra shëmbëlltëre!

Motër Veronika ishte shumë e respektuar nga motrat stigmatine, në përvujtëri fetare si Nënë Tereza. Famullitari Muzhani e kush e njohu thanë se ishte një motër e rrallë dhe tepër e përvuajtur. Vdiq me nderim e respekt të madh në vitin 1958, në moshën 85 vjeçare, për t'u bashkuar me motrën Nënë në lumturimin e Parrizit...

Të paharrueshme do të jenë për ne, duke përkujtuar me respekt të thellë, jetën që bënë këto dy motra të virtytshme dhe rregulltare shembullore. Lanë ndere, emër të mirë në Kuvendin Stigmatin dhe jashtë tij, gjatë gjithë jetës. Qenë një pasqyrë e mirëfilltë e mirësjelljes e

përshtirshmërisë së përvuajtur, që kaluan jetën në thjeshtësi, me uratë e besim të plotë tek i madhi Zot, si shërbëtore të Zojës së Papërlyeme. Pushofshin në paqe, në lumturimin e Parrizit! U lutshin për ne!

Nënë Veronika Muzhani

Në familje quhej Lezina Muzhani, e bija e Mikel Muzhanit dhe Age Ndrekes, lindi në Shkodër, më 10. XI. 1899. Veshi petkun e probandës Stigmatine më 19. IX. 1924, nga Padër Pal Dodaj. Mori emrin Motër Veronika e Krishtit. Ishte e 47 motër shqiptare që veshi petkun e motrave stigmatine të qytetit të Shkodrës.

Kreu filloren te Motrat Stigmatine në Shkodër e më pas vijoi në Austri, ku pati profesor të dalluar. Ishte vajzë me një dashuri të jashtëzakonshme. Familja u shqetësua së tepërmi kur pa se kjo vajzë kaq e bukur, e mirësjellshme, filloi të ndiqte të motrën Konsilen, në jetën e saj fetare. Donin t'i ndërronin mendimin, ndaj vëllai i saj më i vogël, Gaspri, e mori në Vjenë, ku qe punësuar në një bankë të qytetit. Mori motër Veronikën, ku përveç petkave të bukura, shkëlqimit që kryeqyteti i Austro-Hungarisë ofronte, shoqërisë së njohur, shëtitjeve me veturë, teatrove e mjediseve kulturore luksoze, të gjitha këto s'mund të kishin efekt. Por jo... Të gjitha këto nuk patën asnjë efekt te vajza e re dhe e bukur, ato nuk arritën t'ia ndërronin thirrjen e hershme për murgeshë që pati evokim nga Zoja e Këshillit të Mirë. Zëri i Zotit i tregonte rrugën dhe asgjë nuk mund ta ndalte e t'ia ndryshonte drejtimin Hyjnor...

Kërkon me këmbëngulje kthimin në Shkodër, për t'u vendosur në Kuvendin e Stigmatineve, duke braktisur rehatinë familjare. U kthye në Shkodër dhe veshi petkun fetar. Shërbeu në Dajç, Shirokë, Tiranë, Korçë dhe Kishën në Rus, Shkodër.

Kur u përjashtuan nga Kuvendet të gjitha murgeshat, së bashku me Nënë Konsilen, u vendos tek ajo shtëpi e marrë me qira tek Arra e Madhe. Dhomë e ulët përdhese, e errët, me lagështi, vetëm një dritare, ngjasonte më tepër me një qeli burgu. Dhoma kishte një krevat të vetëm ku, sigurisht flinte Konsilja si Nënë Provinciale e motër më e madhe.

Veronika shtronte gjatë natës një dyshek në tokë e, aty flinte, ndërsa e mblidhte atë çdo mëngjes, për ta vënë mbi një arkë rrobash në qoshe të dhomës, për të liruar hapësirën e vogël të dhomës me

madhësinë $3 \times 4 = 12 \text{ m}^2$ me kushte minimale jetese, duke bërë një jetë të përvuajtur, të varfër, vetmitare...

Por, megjithatë, kopshti i asaj shtëpie, që gati po binte brenda, i zinte pleqtë që banonin, Kel e Shaqe Kadaren e me to, edhe motrat Muzhani, ai mbahej gjithë lule prej tyre në përkujdesje të veçantë.

Motra Veronika do të mbahej mend prej të gjitha stigmatineve si një “engjell” që kishte pak fjalë, ishte e vendosur e bujare, e ëmbël dhe e drejtë me të gjithë, model vetëmohimi.

Motër Veronika ka qenë një shenjte e vërtetë. “Sikur të ishin mundësitë, do ta kisha paraqitur me kënaqësi ndonjë ditë çështjen e lumturimit të (E shenjtë) Motër Veronikës”- do të thoshte në mjediset miqësore Pater Pjetër Meshkalla, dijetar jezuit. Bënte një jetë të thjeshtë, të shenjtë, gjithë varfëri e përvujtëri. Dinte të donte, si Krishti, deri në vdekje, gjithë njerëzit me një dashuri fëmijërore”. (Shkroi Dr. Pjeter Pepa, në librin “Tragjedia e Lavdia e Kishës Katolike në Shqipëri”, V.I)

Kuvendi Stigmatin, vëren urtësinë e zgjuarsinë e saj, e dërguan në Universitet të Vjenës për teologji, shkëlqeu në mësim. Njihte gjuhët: Italisht, latinisht, frëngjisht, gjermanisht, mësoi infermierinë dhe ekonominë shtëpiake, qe me kulturë poliedrike. Ditët e fundit të jetës e mjekoi Dr. Polake Danisha dhe i tha: “Kam ndigjue se vajzë ke kenë e hijshme, me le s’dyti, a do baheshe murgeshë”? S’ka njeri që lind së dyti, rruga e ime është Kuvendi Stigmatin, qe turpëruar e mërziur, s’donte lavde, po përvujtëri e devocion. Motër Veronika qe një motër stigmatine tejet e respektuar ndaj sjelljeve të ndërsjella të respektit human të krishterë. Me virtyte përvujtërie, edukate të lartë, mirësjellje e gatshme, me dëshirën për t’i shërbyer të gjithëve, me dhembshuri deri në sakrificë...

Pati një adhurim të veçantë për Zojën e Këshillit të Mirë, për fenë e Jezusin, duke e përkushtuar jetën. Vdekja e Nënë Konsiles Provinciale e Stigmatine, shumë e pikëlloi, e varfëroi këtë motër, pasi kishin kaluar një jetë së bashku.

Si jetoj në atë kolibe dërrasash duke u shembë edhe 5 vjet të tjera! Qe Zoja e Shkodrës që e mbrojti si bijën e saj! Me veshjen e stigmatineve si një veladon fretërisht, pa pallto, me sandale, zbathur, duart pa ngrohje e pa doreza, duart e arta të sajat që punonin ditë e natë për të mbajtur frymën, jetonin pa pension, fituan reumatizëm të fortë, iu deformuan duart. I vetmi mjekim qenë 4 aspirinat në ditë, rënkonte në heshtje e devocion për Zojën e Papërlyeme.

Në prag të vdekjes e la me porosi mos të sjellin lule e kurorë, ato janë për Zojën Hirëplotë.

Në moshën e pleqërisë, 5 vitet e fundit të jetës, pa forcë, qe strehuar tek Angjelin Muzhani, gruaja e tij, Marta, i bënte hyzmet të veçantë. Në 1985, në moshën 85 vjeçare, mbylli sytë për të shkuar, si dëgjuam, në lumturimin e Parrizit, për t’u bashkuar me motrën Nënë Konsilen. E paharrueshme do mbetet si motër shembullore virtytesh të larta të krishtera.

La ndere, emër të mirë në Kuvend e jashtë, si e paharrueshme...Mbetet pasqyrë e mirëfilltë e sjelljeve të përvuajtura të stigmatinëve, motër virtytesh si shenjtore Nënë Tereza.

V. O.: Familja e madhe Mikel Muzhani me 25 vetë, 11 meshkuj, me lashtësi fisnore nga 1274. Unë trashëgimtari i fundit, përkujtova dy hallat Nëna murgesha stigmatine tejet shembullore, që shkrinë jetën si bijat e Zojës. Katedralja e Shkodrës do ishte e drejtë dhe e arsyeshme të orvatet që t’i lumturojë “Të shenjta”.



Ndue DEDAJ
Rrëshen

PREND DOÇI, ABATI I LIRISË DHE DITURISË
(në 100-vjetorin e vdekjes)

Abat Prend Doçi (1846-1917), udhëheqës i lëvizjes kombëtare shqiptare, është një emër dhe vepër që thërret sot e gjithë ditën që historia të rishkruhet, duke zënë secila ngjarje e figurë historike vendin që meriton. Kështu ka ndodhur me të gjitha figurat e kombit që për shkak të ideologjisë marksiste - leniniste ishin të përjashtuara nga trashëgimia jonë historike. Tani nuk na bëjnë më përshtypje të rikthyerit e mëdhenj, Fishta, Konica, Kokalari, së fundi dhe Kostë Çekrezi, por ende i rrimë larg Ernest Koliqit, Mustafa Krujës, Anton Harapit, Mit'hat Frashërit, ani se dhe ata janë sendërtues të ndërgjegjës sonë kombëtare. Njolla në biografinë e tyre politike vazhdon të përcaktojë sërish fatin si figura të historisë dhe kulturës, a thua se personazhet e historisë së Europës kanë qenë të gjithë të kulluar, nga dita e parë te dita e fundit e veprimtarisë së tyre politike. Abat Prend Doçi mund të duket si më i largët në kohë, por është e njëjta qasje ideologjike e përjashtimit të tij nga panteoni i

gjymtuar i kulturës së këtij vendi për gjysmë shekulli (1944-1990). Rilindës i devotshëm i kushtuar lirisë, abetarisë dhe Pavarësisë, që mbetën dhe trinia e tij e shenjtë në altarin e kombit. Një figurë komplekse e kohës së tij, sipas Shahin Kolonjës “shumë i përmendur e pak i njohur”, me ndikim të pazakontë në qarqet politike, kishtarë, diplomatike e kulturore në tri dekadat e fundit të shekullit XIX dhe dy dekadat e para të shekullit XX. Për Prend Doçin, i mbrujtur me tiparet e një burrështetasi, nuk kishte asnjë mision të pamundur, sado i vështirë të ishte, mision apostolik apo kulturologjik, në Kanada apo në Indi, në Shkodër apo në Mirditë, në luftë apo në paqe, prift i thjeshtë apo ordinar kishe. Ai ishte ideator dhe reformator i guximshëm në të gjitha kahet e zhvillimit: në jetën kishtarë, në jetën sociale, në jetën kulturore dhe atë politike. Shqiptari i vetëm që rroi e predikoi në tre kontinente: Europë, Azi dhe Amerikë.

Abati është një titull i lashtë kishtar në Shqipëri, ashtu si dhe në Angli, Francë, Spanjë, Itali, Poloni etj., por ai ndër shqiptarë është i lidhur kryekrejt me një emër, atë Imzot Prend Doçit, çka nuk zbeh rolin e të tjetërve, as të abatit të fundit të Mirditës, Imzot Frano Gjini, i cili ishte dhe ipeshkëv e mbi të gjitha martir i Lumnuar. Doçi është i pashembullit pasi ai ishte Abati rilindas me “penë në dorë dhe pushkë për faqe”, siç do ta përcaktonte Fishta. Për shkak të përfshirjes në politikë ai nuk e mori titullin e ipeshkvit, dhe pse kreu funksion ipeshkvnor dhe ishte mbase më i njohur publikisht e ndërkombëtarisht dhe se vetë argjipeshkvinjë e Shkodrës.

Ka njëqind vite që Abati u shua në Orosh, në rrethana të dyshimta të Luftës së Parë Botërore (ishte pushtimi austro-hungarez), teksa emri i tij ka ardhur vetëm duke u ndriçuar, po ashtu dhe vepra e tij e gjerë, i nderuar së fundi dhe me titullin “Nderi i Kombit”. Studime të vyera rreth kësaj figure eminente të botës shqiptare këto 25 vitet e fundit kanë kryer studiuesi veteran Pal Doçi, historiani bashkëkohor gjerman Peter Bartl në Universitetin e Mynihut, studiuesi skrupuloz shkodran Luigj Martini etj., krahas kumtimeve të bëra kohë pas kohe rreth Abatit nga At Pashk Bardhi, Jup Kastrati, Tomor Osmani, Mark Tirta etj. Pa u shtyrë deri në kohën kur ai rroi, ku për rolin e tij u shpreh e gjithë elita e kohës, përfshi dhe Edith Durham-in që i bën





një portret prej baroni nga lartësitë e Malit të Shenjtë të Oroshit, ku ajo ishte ngjitur për të folur me njërin nga njerëzit më të lartë të Shqipërisë, siç e vlerëson Abatin.

Prend Doçi ishte misionari i lartë i fesë, flamurtari i pacak i lirisë, ideologu i Pavarësisë dhe veprimtari kombëtar i diturisë etj.

Si misionar dhe prelat i kishës katolike, pas një vargu kontributesh fetare në Amerikë e Azi (Indi), ai reformoi Abacinë e Mirditës, nga viti 1888 kur e mori në dorë e deri në vitin 1917 kur u nda nga jeta, duke qendruar në krye të saj për 29 vjet dhe duke e “dëlirë dioqezin e tij prej vesit”, siç shkruajnë bashkëkohësit. Abacia e Oroshit ishte nulus (e pavarur), përndryshe me vartësi të drejtpërdrejtë në Vatikan. Imzot Doçi e gjeti atë të copëtuar, vetëm me dy famulli dhe shpejt e bëri me 16 të tilla, në një territor të gjerë nga Mati në Drin, duke e shtrirë organizimin abacial (rrudhur mbi Orosh e Spaç) edhe në Ndërfanë, Kalivare, Qafë-Mali, Blinisht, Fand e gjer në Kashnjet, Mnelë e Gomsiqe. Nën kujdesin dhe autoritetin e tij institucionet e kultit në krahinën e Mirditës u bënë moderne, duke filluar me godinën e Abacisë. Abati ishte një misionar shumëplanësh i formatit european, i vendosur ta qytetëronte vendin e tij me të gjitha mënyrat e mjetet, me predikimin në kishë, çlirimin kombëtar nga robëria turke, hapjen e shkollave në male, botimin e librave, hartimin e alfabetit të unifikuar, mbledhjen e visarit kulturologjik që po djerrej etj.

Ai si rrallë kush i gërshtëtoi qëllimet e tij politike

me ato të kishës dhe të progresit social-kulturor. Si drejtues kishe do të vepronte ndër 25 mijë mirditas, ku vetëm pesë përqind e tyre dinin shkrim e këndim, gjakmarrja ishte një gangrenë e popullatës, varfëria po ashtu.

Doçi bashkëpunoi me urtësi me Gjomarkajt (Markagjonët), princërit kapidanorë, duke lënë pas mosmarrveshjet dhe konfliktet që paraardhësit e tij kishin patur me qeverisësit tradicionalë të Krahinës, që rronin mes Oroshit dhe Shkodrës. Abati dhe Princi, jo rastësisht ishin me fate të njëjta, të internuar nga Porta e Lartë, Imzot Doçi 12 vjet dhe Prengë Bibë Doda 28 vjet.

Si frymëzues dhe flamurtar i lirisë së Atdheut Abat Doçi është ndër shqiptarët e rrallë me rol drejtues në lëvizjet për liri e pavarësi për dyzet vite, nga kryengritja e Mirditës e vitit 1876 te kryengritjet e Pavarësisë të viteve 1910-1912 në Shqipërinë e Veriut e deri në Luftën e Parë Botërore, mundet dhe si një i sakrifikuar politik i saj. Ai bashkëveproi ngushtë me emblema të qendresës popullore si Dedë Gjo Luli e veprimtarë të tjerë kombëtarë për liri. Rrugëtimi i tij drejt lirisë, përshkruar nga Franz Nopça, nis me arrestimin në Guci nga autoritetet turke, dërgimin në Kostandinopojë dhe lirimimin me kusht që të mos merrej me politikë, për çka dhe “degdiset” më mision fetar për 6 vite në Kanada, në ishujt e largët veriorë amerikanë, si me thënë, në fund të botës. Veçse projekti rilindës i Doçit mund të vonohej, por nuk mund të ndalej, dhe se në luftë me të gjithë. Mjafton kronika e shkruar dhe e pashkruar



e peripecive të tij për rikthimin në Atdhe si misionar fetar, ku brenda petkut kishtar ishte dhe atdhetari, “ma i flakti kombëtar i maleve tona”, siç do ta cilësonte shkrimtari dhe historiani i shquar Ndoc Nikaj. Nuk kishte një kreshtë të historisë më të përshtatshme se Mirdita për aksionin e tij politik, fetar dhe kulturor.

Doçi udhëhiqte dy seli, njërën në Orosh, si kryetar i kishës së Mirditës dhe tjetrën në Shkodër, si kryesues i shoqërisë së njohur “Bashkimi”, por ideali i tij ishte Shqipëria në të gjithë hapësirën e saj etnike, ku ai njihet dhe si hartues i një promemorie për Çamërinë. Abati dhe Mirdita ishin një simbiozë historike, aq më tepër që mirditasit njiheshin si fisi më i fuqishëm luftarak në Shqipërinë Veriore. Kështu ai rrugëtoi gjatë me dy “këmbët” mbështetur fort në Mirditën e papërkulur qendrestare, dokësore dhe në Shkodrën diturore, rrezatuese e qytetërimit europian.

Si ideolog dhe veprimtar i Rilindjes Kombëtare Abati krijoi shoqërinë letrare e gjuhësore “Bashkimi” në Shkodër më 1899, me bashkpunëtorë personalitete si At Gjergj Fishta, Dom Ndoc Nikaj, Luigj Gurakuqi, Dom Dodë Koleci etj., që me të drejtë nga Gurakuqi, në një kumtim me De Radën, është quajtur “akademi”.

Kjo shoqëri elitare për më shumë se një dhjetëvjeçar u mor me alfabetin (e Manastirit), hapjen e shkollave, botimin e librave shkollorë, rreth 35 vepra (fjalorë shqip-italisht, gramatika, abetare, histori, gjeografi etj.) Inteligjenca dhe talenti letrar i Doçit pati spikatur që kur ishte student për teologji në Romë dhe shkroi lirikën e para atdhetare si “Shqipnia nën zgjedhën turke”, “Një kushttrim shqiptarëve”, apo përfshirja e tij në një përmbledhje poetike të shqiptarëve kushtuar Dora D’Istrias (Elena Gjika) përgatitur nga Dhimitër Kamarda. Arbëreshët ishin “gjaku i pashprishun” për shqiptarët këndej Adriatikut, që venin atje kohë pas kohe, nga Prend Doçi te Martin Camaj etj., për të shijuar verën e vjetër të shqipes së pasosur.

Është folur e shkruar shumë për “Abatin”, këtë kalorës mendjendritur të Rilindjes, që do të vazhdojë të identifikohet si asnjë tjetër me këtë emër, të cilit i dha një kuptim të ri ndër shqiptarë, përtej titullit të prelatit kishtar, por sado të flitet e shkruhet për Imzotin, motivi i çdo nderimi gjendet në fjalët e Gjergj Fishtës:

“Abati ka një meritim të madh para Atdheut e Kombit”.

SI E KUJTOI NËNË TEREZA PRANIMIN E ÇMIMIN NOBEL PËR PAQE

Data e 17 tetorin e vitit 1979, na kujton ditën, kur Juria ndërkombëtare e Akademisë së Shkencave të Suedisë nderoi me Çmimin Nobel për paqen Shenjtën shqiptare, Ganxhe Bojaxhiu, Nënë Terezën.

Rregulltarja e madhe u ngjiti në tribunën ku janë ngjitur njerëzit më të shquar të botës nga të gjitha fushat, veshur me sarin e grave të varfra indiane dhe e pranoi çmimin për paqe vetëm sepse një pranim i tillë do t'u vlente shumë të varfërve të saj. E, kur iu desh të jepte një nga intervistat më të rëndësishme, në tribunën e Oslos, duke marrë në dorëzim Çmimin Nobel, Shën Nënë Tereza foli në një mënyrë krejtësisht të padëgjuar në atë sallë, që ka parë e ka dëgjuar mendjet më të ndritura të njerëzimit.

Ja si e kujton e Shën Ganxhe Bojaxhiu, Nënë Terezë këtë ngjarje:

“Duhet të them se pranoj të shkoj në ceremoni të ndryshme publike, vetëm sepse më krijohet mundësia t'u flas për Jezusin njerëzve, të cilët nuk dihet në se do të kishin ndonjë rast tjetër për të dëgjuar fjalën e Zotit.

Një herë kam thënë edhe se e kam më të lehtë të mjekoj një të gërbulur, sesa të përgjigjem në një intervistë.

Në Oslo ndodhi një mrekulli e vërtetë: u lutën të gjithë, në një vend ku s'ishte dëgjuar kurrë ndonjë lutje. Ishim mbledhur në një sallë për dorëzimin e Çmimit e, sapo m'u dha mundësia të flas, thashë: “Me që jemi mbledhur të gjithë për të falënderuar Zotin e Çmimit Nobel për Paqen, mendoj se do të ishte vërtetë e bukur të luteshim për paqen”.

E të gjithë së bashku nisëm lutjen e Shën Françeskut: “Zot, më bëj lajmëtar të paqes sate”, teksti i së cilës u qe shpërndarë të pranishmëve. Ishte diçka vërtetë tronditëse. Prekëse. E mrekullueshme: luteshin të gjithë, ndonëse siç dihet, numri i katolikëve në Norvegji është shumë i vogël.

Më pas – tha Nënë Tereza - fola për abortin e thashë:

“Po kremtojmë vitin ndërkombëtar të Fëmijës. Sot po ju flas për fëmijën, që nuk ka lindur akoma. Po ju flas në emër të fëmijës, që nuk e ka parë ende dritën e diellit. Të abortosh do të thotë ta dënosh fëmijën me vdekje: të mos duash që fëmija të jetojë, do të thotë ta vrasësh. Sot për sot, arma më e rrezikshme kundër paqes, është aborti. Shumëkush interesohet për fëmijët e Indisë e të Afrikës, ku vdesin me mijëra nga mungesa e ushqimit. Por në vende të tjera miliona fëmijë mbyten nga vetë prindërit e tyre. E në se një nënë mbyti fëmijën e vet, pse u dashka të çuditemi, kur njerëzit ia marrin shpirtin njëri-tjetrit?!”.

Duke kaluar nëpër Romë, gjatë udhëtimit të kthimit, Papa më tha: “Mos harro të flasësh si në Oslo, kudo që të shkosh!”.





Konferenca Ipeshvore
e Shqipërisë

ZOJA E SHKODRËS

Gjergj Fishta
Lezhë, 2017



Didler Chardez

Nënë Tereza

Fjala Hyjnore
Prizren - Shkodër - 2017



Dom Ernesto Cozzi

STUDIME ETNOLOGJIKE

Gjergj Fishta
Lezhë - 2017

KUMBONA E SË DIELLËS

revistë fetaro-kulturore dymujore
e Kryedioqezës Metropolitane Shkodër-Pult

Tirazhi: 1000 kopje

Çmimi: 100 lekë (Evropë: 2 Euro)

Parapagimi vjetor 600 lekë
(Evropë: 12 Euro)

e-mail: n_ukgjini@yahoo.it

Web page: www.kishakatolikeshkoder.com

Adresa: Arqipeshkvia Shkodër,
Sheshi "Gjon Pali II"

Shtypur në Entin Botues "Gjergj Fishta" - Lezhë